

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5799
E mërkurë, 12 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Gjeopolitika
e marrëveshjes
Kosovë - Serbi | FAQE 10-11



Prof. dr.
Blerim REKA

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**JO SI 'PARAMILITARË'!
IVICA DAÇIQI ËSHTË
PËRFAQËSUES I DENJË
I SHTETIT QË KREU
GJENOCID NË KOSOVË F. 11**

Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI



AKTUALE

**QEVERIA NDAN 200 MIJË
EURO PËR KOMPLEKSIN
MEMORIAL 'ADEM JASHARI'**

F. 3

**KROACIA DO TA NDIHMOJË
KOSOVËN NË PROCESIN E
INTEGRIMIT NË NATO F. 7**

EKONOMI

**974 ZYRTARË TË
LARTË PUBLIKË DO
T'I NËNSHTROHEN
KONTROLLIT TË PASURISË F. 9**

**MINISTRI SHALA URDHËRON
INSPEKTORATIN PËR
KONTROLLIMIN E HOTELEVE F. 9**

KULTURË

**EDI SHUKRIU SHPALLET
FITUESE E ÇMIMIT LETRAR
'BEQIR MUSLIU' 2019 F. 8**

SPORT

**HENDBOLL
KOSOVA ME SYNIME TË MËDHA
NDAJ POLONISË F. 8**

ISH-PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË KOSOVËS (SHBA),
BILL CLINTON, DHE ISH-SEKRETARJA E SHTETIT, MADELEINE ALBRIGHT,
KANË ARRITUR TË MARTËN PËR VIZITË NË KOSOVË

HEROI I LIRISË SË KOSOVËS



**Bill Clinton:
Gjithmonë do të jem
krenar që unë isha
president i ShBA-së
në kohën kur ju
patët nevojë që
dikush të ngritët dhe
të thotë se nuk ka
më spastrim etnik**



Miku i madh i Kosovës, ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Bill Clinton, ka arritur të martën në Kosovë për nder të 20-vjetorit të lirisë së Kosovës. Ai është pritur me nderime të larta shtetërore nga liderët institucionalë të shtetit të Kosovës, duke u vlerësuar si heroi i lirisë së Kosovës. Teksa presidenti

Hashim Thaçi ka nderuar mikun e Kosovës me "Urdhrin e Lirisë", presidenti Clinton ka thënë se ndihet krenar që ishte president i ShBA-së në kohën e marrjes së vendimit për ndërhyrje ushtarake në Kosovë. Sipas tij, Kosova meriton të jetë pjesë e NATO-s, BE-së dhe çdo organizatë ndërkombëtare

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERAMBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Në Prishtinë u mbajt takimi i drejtorëve të doganave të rajonit, u diskutua për lehtësimin e tregtisë

Në takimin e drejtorëve të përgjithshëm të doganave të vendeve të Ballkanit ministri i Financave Bedri Hamza ka thënë se do ta mbështesë çdo vendim apo projekt në fushën e doganave, me qëllim të lehtësimit të të bërit biznes dhe krijimit të kushteve më të mira për investitorët e jashtëm dhe për një zhvillim ekonomik



të doganave, të cilat takime janë me rëndësi të madhe për vendet tona në zhvillimin dhe ndërtimin e kapaciteteve doganore, të bashkëpunimit rajonal, të shkëmbimit të informacioneve dhe praktikave të mira në fushën e doganave, që kanë ndikim edhe në zhvillimin ekonomik të vendeve tona rajonale. Dëshiroj t'i falënderoj edhe organizatat e tjera ndërkombëtare për përpjekjet e tyre të vazhdueshme në rajon për të ndihmuar nga programet e tyre, aktivitetet që lidhen me konceptin rajonal të bashkëpunimit", ka thënë ministri Hamza.

Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Financave do të jenë në përkrahje të këtyre iniciative në fushën e doganave dhe bashkëpunimit rajonal, me partnerët ndërkombëtarë në shërbim të çdo iniciative që shkon në drejtim të lehtësimeve tregtare dhe qarkullimit të mallrave, luftimit të kontrabandës dhe krimeve ndërkufitare. "Do ta mbështes çdo vendim apo projekt në fushën e doganave, me qëllim të lehtësimit të të bërit biznes dhe krijimit të

kushteve më të mira për investitorët e jashtëm dhe për një zhvillim ekonomik", ka thënë Hamza.

Kurse drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka thënë se doganat në rajonin tonë kanë një mision të gjerë, duke filluar nga fusha e të hyrave, lehtësimi i tregtisë, luftimi i krimeve ndërkufitare, ekonomia joformale dhe mbrojtja e shoqërisë nga mallrat e ndaluara. "Duke

qenë se doganat kanë një mision të gjerë dhe vlerësohen si një nga institucionet me më rëndësi për vendet tona, ne vlerësojmë se qeveritë e vendeve tona, komuniteti i biznesit, por edhe qytetarët e vendeve tona, do të vazhdojnë të kenë pritje të mëdha nga doganat për lehtësimin e tregtisë, lëvizjes së njerëzve, mallrave, por edhe për luftimin e kontrabandës dhe krimeve transkufitare", ka thënë Berisha.

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Të martën në Prishtinë për herë të parë është mbajtur takimi i drejtorëve të përgjithshëm të doganave të vendeve të Ballkanit me përkrahjen e Doganës britanike. Në këtë takim morën pjesë ministri i Financave, Bedri Hamza, ambasadori britanik Ruairi O'Connell, drejtorët e përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Doganës së Shqipërisë, Doganës së Maqedonisë së Veriut dhe Doganës së Malit të Zi. "Më lejoni fillimisht ta falënderoj Qeverinë e Britanisë së Madhe për përkrahjen e këtyre takimeve rajonale të drejtuesve

Meta: Me Ramën kam zhvilluar disa takime sekrete

TIRANË, 11 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta ka zbardhur prapaskenat e marrjes së vendimit për shfuqizimin e 30 qershorit si datë për zgjedhjet lokale.

Gjatë konferencës me gazetarët, Meta deklaroi se Lulzim Basha, kryetar i opozitës, është njoftuar për dekretin e shfuqizimit të 30 qershorit, rreth orës 19:10 të 8 qershorit. Biseda telefonike me Bashën, tha Meta, është e regjistruar.

"Basha këtë vendim e ka marrë vesh vetëm në orën 19:10 përmes një telefonate zyrtare, dhe për dijeninë tuaj, Basha nuk e ka ditur por le ta marrë vesh tani, e cila ka qenë e regjistruar përmes sekretarisë, ku i është kërkuar të ndër-



pritet mitingu në çdo moment që do të ketë një manifestim dhune, natyrisht duke i bërë të ditur edhe faktin tjetër që do të bëhej publik,

vendimi për të shfuqizuar dekretin për zgjedhjet në mënyrë që të ç'tensionohej sa më shumë manifestimi apo grupet e caktu-

ara dhe po kështu që të përfundonte sa më shpejt ai manifestim", u shpreh Meta.

Në lidhje me një drekë të zhvilluar me ish-kryeministrin Sali Berisha, Meta tha: "Dreka me Berishën nuk ishte sekret, por moment relaksi. Kolegët tuaj (gazetarët) më ftuan, nuk më ftoi Berisha dhe unë pata shumë kënaqësi."

Presidenti Meta pranoi se gjatë kësaj periudhe krize ka zhvilluar disa takime sekrete me kryeministrin Edi Rama.

"Kemi pasur një drekë sekrete, kemi pasur disa dhe më e fundit në Pallatin e Brigadave përpara 10 ditësh, ku kemi biseduar dhe ku ai e di shumë mirë dhe e ka ditur

gjithmonë se sa i shqetësuar unë jam për këtë situatë dhe për tejkalimin e saj. I takonte atij si kryeministër të kërkonte shtyrjen për një datë tjetër për zgjedhjet vendore", tha Meta.

Gjithsesi, presidenti theksoi se nuk e kishte njoftuar Ramën më 8 qershor për vendimin për anulimin e datës së zgjedhjes, ndërkohë që ka pasur një përpjekje për t'u lidhur me kryeparlamentarin Gramoz Ruçi.

Gjatë konferencës, Ilir Meta tha se me vendimin për anulimin e 30 qershorit ka bërë të mundur shmangien e një konflikti civil në Shqipëri, që do të provokohej më shumë nga grupe të caktuara jashtë vendit.

Basha: Jemi gati të mbrojmë rendin kushtetues

TIRANË, 11 QERSHOR - Një ditë pasi në mbledhjen e Kryesisë së Partisë Demokratike u votua për ngritjen e 'Aleancës Qytetare për Mbrojtjen e Demokracisë', kryetari Lulzim Basha është shprehur të martën në Këshillin Kombëtar se objektivi kryesor i PD-së dhe i opozitës së bashkuar është largimi i kryeministrit Edi Rama, si mënyra e vetme për të garantuar zgjedhje të

lira e të ndershme. Mbledhja e Këshillit u realizua për të diskutuar situatën politike, pasi presidenti Ilir Meta nxori një dekret të ri për shfuqizimin e 30 qershorit si ditën e zhvillimit të zgjedhjeve lokale.

"Ne ia dolëm që të ndalojmë procesin fals dhe kriminal të 30 qershorit. Tashmë është e qartë që nuk do ketë zgjedhje lokale pa

opozitën", është shprehur kreu i opozitës, duke vënë në dukje se gjithçka që ka ndodhur deri tani për frenimin e një procesi kriminal njëpartiak është meritë e drejtëpërdrejtë e qëndresës së shqiptarëve të bashkuar, përtej bindjeve politike.

Basha raportohet se ka përforcuar mesazhin kryesor të opozitës se "zgjedhjet pa dekret presidenti

nuk janë zgjedhje dhe se zgjedhjet pa opozitën nuk janë zgjedhje". Basha u ka kërkuar gjithashtu anëtarëve të Këshillit që gjatë gjithë kësaj kohe të rrisin angazhimin publik qytetar në nivelin më maksimal.

"Ne duhet të jemi gati të bëjmë detyrën tonë për të mbrojtur demokracinë dhe rendin kushtetues dhe për të mos pran-



uar asnjë proces votimi fals, në shkelje dhe dhunim të Kushtetutës", mësohet të jetë shprehur Basha, duke shtuar se këto javë janë përcaktuese për 10-15 vitet e ardhshme.

Është mbajtur mbledhja e radhës e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Qeveria ndan 200 mijë euro për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'

Kabineti qeveritar të martën ka ndarë 200 mijë euro për restaurimin e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ky vendim është marrë me kërkesë të Komitetit Ndërmintor për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" dhe mjetet financiare do të përdoren për nevojat e realizimit të këtij projekti përmes angazhimit edhe të konsulencës së jashtme. Po ashtu, qeveria ka aprovuar propozim vendimin për t'i proceduar Kuvendit mendimin lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Avni Ahmeti është emëruar drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës

tratën publike është ndryshuar përbërja e komisionit ekzekutiv të kësaj strukture. Në këtë komision do të shtohen edhe tre përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka emëruar Avni Ahmetin drejtor të përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës me mandat tre vjeçar.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe ndryshimin e listës së artikujve për përdorim të përbashkët, që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik në Republikën e Kosovës. Ndërkohë kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar sqarime nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) për procedurat e akreditimit të programeve të studimit në institucionet e larta të arsimit në Republikën e Kosovës dhe bazat e ligjshmërisë së këtij procesi.

Kurse ministri i Arsimit, i

Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka sqaruar se baza ligjore e këtij procesi është Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe implementohet nga Këshilli Kombëtar i Cilësisë dhe Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.

Me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Rustem Berisha, në bazë të kërkesës së familjeve të të rënëve, është miratuar vendimi që Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ta vazhdojë rivarrimin e të rënëve në Kompleksin Memorial në Marinë të Skenderajt.

Po me propozimin e ministrit Berisha, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes është emëruar në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Mjekësisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është transferuar në pozitën e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e së martës ka ndarë 200 mijë euro për Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Vendimi është marrë me kërkesë të Komitetit Ndërmintor për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" dhe mjete financiare do të përdoren për nevojat e realizimit të këtij projekti përmes angazhimit edhe të konsulencës së jashtme. Po në këtë mbledhje Qeveria e Kosovës ka dhënë

mendimin për iniciativën legjislative për Projektligjin për ndryshim dhe plotësim e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, sipas përfundimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. "Mendimi i qeverisë me vlerësimet e Ministrisë së Drejtësisë thekson se iniciativa për këtë Projektligj do të ndihmojë në eliminimin e paqartësive eventuale në procesin e zbatimit; vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe vlerësimin e përputhshmërisë së iniciativës me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritimit Evropian,

do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës", është thënë në komunikatën e Qeverisë së Kosovës.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore Telekomit i Kosovës. Me vendimin e miratuar është zëvendësuar një anëtar i dorëhequr i këtij bordi. Me plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të qeverisë për themelimin e strukturave për zbatimin e pakos ligjore për adminis-



Këshilli ndërministror diskuton për veprimet e ndërmarra kundër etheve hemorragjike

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Nën udhëheqjen e ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Ndërmintor për Luftimin dhe Parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHCC). Ministri Ismaili ka thënë se takimi i Këshillit po mbahet me qëllim të përcjelljes sa më të mirë të zbatimit të masave për kontrollin e etheve hemorragjike për të ndikuar në uljen e kësaj sëmundjeje e cila shkaktohet si pasojë e pickimit

dhe infektimit nga rriqrat.

Ismaili ka kërkuar nga të gjitha institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e planit operativ për parandalimin dhe luftimin e EHCC-së që ta rrisin angazhimin gjatë kësaj periudhe kur frekuenca e rasteve mund të jetë më e shprehur.

Drejtori i Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike (IKShP), Naser Ramadani, ka thënë se në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera po zbatohen aktivitetet e planit operacional me qëllim të parandalimit dhe luftimit të EHCC-së, kurse zyrtarë nga Ministria e Bujqësisë,

Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës njoftuan se në terren po bëhet dezinfektimi i hapësirave bashkë me komunat që njihen si zona endemike (Malishevë, Suharekë, Rahovec e Klinë), si dhe repelimi i kafshëve si masë parandaluese.

Këshilli, gjithashtu, u bënë thirrje qytetarëve të kenë kujdes të shtuar gjatë kësaj sezone duke zbatuar masat e përgjithshme për mbrojtje nga ethet hemorragjike, ndërsa në rast të pickimit nga rriqrat të lajmërohen te mjeku më i afërt në kujdesin primar shëndetësor.



Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Kosovës (ShBA), Bill Clinton, dhe ish-sekretarja e Shtetit, Madeleine

HEROI I LIRISË

- Bill Clinton: Gjithmonë do të jem krenar që unë isha president i ShBA-së në kohën kur ju patët nevojë që dikush të ngritët dhe të thotë se nuk ka më spastrim etnik

Miku i madh i Kosovës, ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Bill Clinton, ka arritur të martën në Kosovë për nder të 20-vjetorit të lirisë së Kosovës. Ai është pritur me nderime të larta shtetërore nga liderët institucionalë të shtetit të Kosovës, duke u vlerësuar si heroi i lirisë së Kosovës. Teksa presidenti Hashim Thaçi ka nderuar mikun e Kosovës me "Urdhrin e Lirisë", presidenti Clinton ka thënë se ndihet krenar që ishte president i ShBA-së në kohën e marrjes së vendimit për ndërhyrje ushtarake në Kosovë. Sipas tij, Kosova meriton të jetë pjesë e NATO-s, BE-së dhe çdo organizate ndërkombëtare



EPOKA E MUHAMET KOCI

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Republika e Kosovës i ka shprehur mirënjohje të thellë ish-presidentit amerikan Bill Clinton teksa ka arritur në Prishtinë për të marrë pjesë në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës. Në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë ai ka mbërritur paraditen e së martës. Aty Garda e Nderit e Forcës së Sigurisë ishte rreshtuar për ta nderuar ardhjen e mikut të madh të Kosovës. Të parët që i kanë uruar mirëseardhje ish-presidentit amerikan ishin ish-presidentja Atifete Jahjaga dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Pasditen e së martës Clintoni ka takuar presidentin e Kosovës,

Hashim Thaçi, i cili i ndau ish-presidentit amerikan "Urdhrin e Lirisë" për merita të veçanta për lirinë e Kosovës. Ish-presidenti Bill Clinton, pasi ka pranuar dekoratën, ka thënë se Republika e Kosovës meriton të jetë në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në çdo organizatë ndërkombëtare. "Isha i lumtur që pasardhësi im, presidenti George W. Bush, njohu Kosovën, besoj vetëm një ditë pasi ju shpallët pavarësinë", ka deklaruar Clinton. Ai ka vlerësuar se ndihej krenar që ishte president i ShBA-së në kohën kur u mor vendimi për ndërhyrje ushtarake në Kosovë. "Unë gjithmonë do të jem krenar me faktin se unë isha president i ShBA-së në kohën kur ju patët nevojë që dikush të ngritët dhe të thotë se nuk ka më

spastrim etnik, nuk ka më përndjekje të njerëzve nga shtetëpitë e tyre, jo më vrasje të civilëve të pafajshëm", ka thënë Clinton.

Sipas ish-shefit të Shtëpisë së Bardhë, jo vetëm ShBA-ja, por gjithë bota duhet të jetë krenare me të arriturat në Kosovë, demokracinë e saj dhe shtetndërtimin. Ai e ka inkurajuar lidërshpin e Kosovës që tani ta ndërtojë paqen brenda dhe jashtë kufijve të Kosovës, për të dëshmuar se është shtet demokratik. "Kosova është shembull i demokracisë dhe

përkushtimit për të jetuar në paqe me fqinjët që është diçka që të gjitha shtetet e mëdha dhe të vogla duhet ta bëjnë", është shprehur ai.

Kurse presidenti Thaçi ka thënë se presidenti Clinton është simbol i besimit, optimizmit dhe shpresës për qytetarët e Kosovës. Ai ka pohuar se presidenti Clinton ishte lideri që bashkoi botën kundër padrejtësive, ishte politikani më këmbëngulës për ta siguruar lirinë e Kosovës. "Ne përulemi me një mirënjohje të thellë para jush për lirinë e Kosovës. Shprehim mirënjohje të madhe për ShBA-në që udhëhoqi në fushatën për ta ndaluar spastrimin etnik dhe për t'i kthyer në shtetëpitë e tyre qytetarët e Kosovës, për të rindërtuar jetë të re dhe paqe për të gjithë", ka thënë presidenti Thaçi, duke e falënderuar ish-presidentin amerikan për kontributin e dhënë. "Dhe nuk ka se si të mos ndihemi krenarë që këtij kontribuuesi të madh të lirisë sonë t'i shprehim mirënjohjen e thellë që populli i Kosovës ndien për të. Faleminderit president Clinton!", ka deklaruar Thaçi.

Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij për lirinë e Kosovës, presidenti Thaçi e ka dekoruar presidentin Clinton me "Urdhrin e Lirisë". "Duke u bazuar në kompetencat e mia si president i Kosovës, por edhe si mik i juaji, sot ndaj çmimin në emër të institucioneve të Kosovës, popullit të

Kosovës, 'Urdhrin e Lirisë'. Nuk ka çmim që mund të shpërblejë atë kontribut tuajin, se dekorimi më i madh është liria e vendit të Kosovës që ka reflektuar me paqe dhe stabilitet në krah të Ballkanin Perëndimor", ka deklaruar Thaçi. Clintoni më pas është takuar me kryeministrin

Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se presidenti amerikan e ndihmoi Kosovën ta fitojë luftën dhe ta ndërtojë paqen. "Falë vendosmërisë, humanizmit dhe guximit tuaj, ne jetësuam të drejtën tonë për liri dhe demokraci dhe ndërtoam shtetin e Kosovës. Falë kësaj kthese historike fëmijët tanë sot jetojnë të lirë. Të lirë për të pasur jetë, për të pasur ëndrra, për ta pasur shtetin e tyre, Kosovën", ka thënë kryeministri gjatë takimit me ish-presidentin Clinton.

Haradinaj ka thënë se presidenti Bill Clinton ka merita të veçanta që Kosova sot frymon lirshëm, që Kosova sot është shtet i pavarur dhe sovran. "Miqësia jonë me ju, bashkëshorten tuaj, ish-sekretaren e shtetit, Hillary Clinton dhe në përgjithësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të jetë e përjetshme", ka thënë Haradinaj, duke e falënderuar për zemërsisht ish-presidentin Clinton për mbështetjen e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë dhënë dhe po vazhdojnë t'i japin Kosovës edhe në ditët e sotme.

Presidenti amerikan po qëndron në Kosovë për të marrë pjesë në



Albright, kanë arritur të martën për vizitë në Kosovë

SË KOSOVËS



Edhe Albright arrin në Kosovë

Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, e ka mirëpritur të martën në aeroportin e Prishtinës ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright. Në profilin e saj në "Facebook", Jahjaga ka shkruar se Albright është një nga kontribueset më të fuqishme për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Jam krenare që njëzet vjet pas çlirimit ta mirëpres në Kosovë ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Madeline Albright, njëren nga kontribueset më të fuqishme në lirinë dhe pavarës-

inë tonë. Vendosmëria dhe përkushtimi i sekretares Albright për ta ndaluar gjenocidin në Kosovë dhe për t'ia kthyer lirinë dhe shpresën një populli të shtypur ishin kryciale për të ardhmen e popullit tonë. Sekretarja Albright, e cila ishte e pakompromis ndaj dhunës që ushtronte në Kosovë, sot erdhi në një Kosovë që kultivon vlerat për të cilat ajo është angazhuar - lirinë, demokracinë, tolerancën dhe paqen", ka shkruar Jahjaga.



aktivitetet që po organizohen për shënimin e 20-vjetorit të hyrjes së trupave të KFOR-it (NATO-s) në Kosovë, që shënon edhe 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës. Ndërhyrja e NATO-s, përkatësisht dislokimi i trupave paqeruajtëse të KFOR-it më 12 qershor 1999, pasoi fushatën e sulmeve ajrore të Aleancës Veri-Atlantike kundër caqeve serbe në Kosovë dhe në Serbi që zgjati 78 ditë.



KFOR-i shënon 20-vjetorin e hyrjes në Kosovë

KFOR-i ka shënuar të martën ceremoninë e 20-vjetorit të hyrjes në Kosovë. Në këtë ceremoni udhëheqësit ushtarakë të kësaj force janë shprehur krenarë që gjatë dy dekadave kanë garantuar sigurinë në Kosovë. Komandanti i Komandës së Përbashkët të Forcave Aleate në Napoli, admiral James Foggo, i cili ka marrë pjesë në këtë ceremoni, ka thënë se KFOR-i është operacioni më i madh i NATO-s

në Evropë. "Ishte qershori i vitit 1999, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara e themeloi Forcën për Kosovën si prani ndërkombëtare të sigurisë e autorizuar për të krijuar një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit në Kosovë. Mund të shikojmë prapa me kënaqësi se KFOR-i e ka bërë këtë. KFOR-i është operacioni më i madh i NATO-s në Evropë. Ai mbetet në Kosovë

sot si forcë që garanton një mjedis të qetë dhe të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet", ka deklaruar ai. Admirali amerikan ka uruar gjeneratën e re të paqes dhe ka lavdëruar përpjekjet e tyre për të ndërtuar të ardhmen më të mirë. "Në 20-vjetorin e KFOR-it i inkurajoj të gjithë të reflektojnë. Po, është koha të kujtojmë, por edhe të ecim përpara", ka deklaruar Foggo.

Ndërsa komandant i KFOR-it, Lorenzo D'Adario, ka thënë se kur e mendon Prishtinën e 20 vjetëve më parë, i kujtohet ndjenja e dëshpërimit dhe frikës. Kur mendoj Prishtinën e vitit 1999 më kujtohet ndjenja e dëshpërimit dhe frikës, por edhe ndjenjës që më e keqja kishte mbaruar pas atyre muajve



shkatërrimtarë të luftës. Shumë njerëz ishin zhvendosur, kishte mungesë të sigurisë dhe shërbimeve themelore", ka thënë D'Adario.

Ministri Bytyqi: Kosova ka nevojë për fushën e konsulencës

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi, ka marrë pjesë në shënimin e Ditës Globale të Konsulencës, e cila për të dytën herë po organizohet në Kosovë nga Business Consultants Council, në

bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim - BERZh.

Qëllimi i shënimin të Ditës Ndërkombëtare të Konsulencës është diskutimi për perspektivën, rëndësinë dhe njohjen e konsulencës si profesion dhe rrjetëzim me aktorë institucionalë, biznese dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Ministri Bytyqi me këtë rast tha se Kosova ka nevojë për fushën e konsulencës edhe në sferën private, por gjithsesi edhe në institucionet publike, ndërsa ka theksuar se promovimi dhe ruajtja e standardeve profesionale të konsulencës në vitet e fundit ka marrë hov në Kosovë. "Duke parë zhvillimet e hovshme në tregun e brendshëm dhe atë

ndërkombëtar, shohim se është shumë e nevojshme të kemi një zhvillim të konsulencës, sepse është mënyra më e mirë për vendimmarrje. Çdo vendimmarrje që bëhet pa një analizë të mirëfilltë dhe pa një ekspertizë, e cila vjen vetëm nga ekspertët e fushave të cilët i njohin problematikat dhe ato njohuri ia ofrojnë menaxhmentit, është

vendimmarrje jo e drejtë", ka thënë ministri Bytyqi.

Duke theksuar rëndësinë dhe njohjen e konsulencës, ministri Bytyqi përmendi konsulencën e ofruar nga Komisioni Evropian për rishikimin funksional të MASHT-it. Dita Globale e Konsulencës manifestohet si një organizim global në 53 shtete të ndryshme të botës.



Projekti i binjakëzimit, kontribuues për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore të reformave për integrim



PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Në konferencën përmblylëse të projektit të binjakëzimit, ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka vlerësuar lart projektin i cili për gjatë dy vjetëve të asistencës ka dhënë kontribut të çmuar në forcimin e kapaciteteve të administratës publike për adresimin e kërkesave që dalin nga procesi i Stabilizim Asociimit për Kosovën.

Në këtë konferencë morën pjesë edhe ministri Mahir Jaghillar, ambasadori gjerman

Christian Heldt, menaxhmenti i projektit të binjakëzimit dhe përfaqësues të lartë të shtetit. "Projekti i BE-së është në përputhje të plotë me projeksionet qeveritare për reformimin e administratës publike", ka thënë ministrja Hoxha, duke vënë theks në ngritjen e kapaciteteve institucionale në përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së. "Falë kësaj përkrahje ne do të kemi plane veprimi dhe pasqyrë të qartë sa i përket përafrimit tonë me Acquis të

BE-së që do të vazhdojë të jetë e dobishme për tetë fushat përkatëse edhe pas përfundimit të projektit", ka thënë ministrja Hoxha, e cila ka falënderuar BE-në dhe shtetet mike, Gjermaninë, Poloninë dhe Kroacinë, për kontributin e tyre dhënë për Kosovën.

Projekti i binjakëzimit ka zgjatur 25 muaj dhe ministrja Hoxha ka dhënë vlerësime për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për procesin e gjatë dhe kompleks të reformave për integrim.

Rezonanca Magnetike në QKUK pajiset me spirale për qafë, bark dhe krah

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Rezonancës magnetike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës i janë ndërruar spiralet për të parën herë, ndonëse kishte nevojë qëmoti. "Spiralet janë pjesë përbërëse e rezonancës magnetike, krijojnë dhe pranojnë sinjale, të cilat transformohen në imazhe. Nga bux-

heti i saj, në përputhje me kërkesën e Klinikës së Radiologjisë, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka ndarë mjete për blerje të tri spiraleve me kualitet të lartë: për qafë, bark dhe krah", është thënë në njoftimin e QKUK-së. QKUK-ja nuk ka ofruar më herët shërbime të rezonancës magnetike për krahë të cilin do ta ofrojë brenda pak ditësh. "Radiologjia po transformohet

në një klinikë moderne. Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK kanë ndarë një buxhet të konsiderueshëm rreth investimeve kapitale këtë vit për Klinikën e Radiologjisë, gjersa rezonanca e dytë magnetike, bashkë me Tomografinë e Kompjuterizuar (CT) 16 shtresore, të blera së fundmi, do të instalohen shumë shpejt", është theksuar në njoftimin për media.



Shefi i shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, gjenerali Mirko Shundov, ka vizituar Kosovën

Kroacia do ta ndihmojë Kosovën në procesin e integritimit në NATO

Shefi i shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjenerali Mirko Shundov, të martën në Prishtinë ka ofruar mbështetjen kroate për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Ai ka thënë se Kroacia është e gatshme ta ndajë përvojën me shtetin e Kosovës në rrugëtimin euroatlantik. Gjenerali kroat Shundov është zotuar për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve me qëllim të forcimit të paqes në rajon

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Shefi i shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjenerali Mirko Shundov, të martën ka qëndruar për vizitë në shtetin e Kosovës ku është pritur në takime të ndara nga Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, komandanti i ushtrisë, Rahman Rama dhe kryeministri Ramush Haradinaj.

Gjenerali kroat Shundov, i cili është pritur me nderime të larta shtetërore, ka thënë se Kroacia është e gatshme që ta ndihmojë Kosovën në rrugëtimin drejt NATO-s. Ai është zotuar për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve me qëllim të forcimit të paqes në rajon. "Ekziston bashkëpunimi bilateral në mes të dy shteteve për zhvillimin e

më tutjeshëm. Ushtria kroate është e gatshme të ndajë me Kosovën dhe ushtrinë e saj përvojën për anëtarësimin në NATO dhe për forcimin e bashkëpunimit me qëllim të forcimit të paqes në rajon", ka deklaruar gjenerali Shundov në një konferencë të përbashkët me komandantin e ushtrisë së Kosovës Rahman Ramën. Ai ka ftuar ushtarët e Kosovës që t'i përdorin prodhimet për çështje të sigurisë të Kroacisë sepse, sipas tij, janë të sigurta. "Ne jemi dy popuj që njohim njëri-tjetrin, prandaj thërras FSK-në t'i përdorë prodhimet për çështje të sigurisë të Kroacisë sepse janë produkte të sigurta dhe ushtria kroate përdor këto prodhime për misione siç janë pistoletat, pushkët, uniformat, helmetat dhe të tjera", ka theksuar gjenerali Shundov.



Ndërsa komandanti i ushtrisë së Republikës së Kosovës, Rahman Rama, ka thënë se Kroacia është partnere strategjike e shtetit tonë. Sipas tij, Kosova dhe Kroacia do ta thellojnë bashkëpunimin bilateral në të ardhmen. "Kroacia është partnere strategjike e Kosovës me të cilën kemi bashkëpunim dhe besim. Synimi ynë është të jemi pjesë në të gjitha iniciativat

rajonale dhe pjesë e strukturave euroatlantike. Do t'i marrim përvojat nga shteti kroat dhe ushtria kroate sepse janë pjesë e NATO-s. Kjo rrugë për ne është e padiskutueshme që bashkë me partnerët të jemi pjesë e saj", ka deklaruar Rama. Ai ka falënderuar gjeneralin kroat për mbështetjen e vazhdueshme që Kroacia i ka dhënë Kosovës. "Kroacia i ka

dhënë mbështetje Kosovës në të gjitha fazat, prandaj falënderoj gjeneralin për këtë përkrahje të vazhdueshme. Edhe tani ushtria kroate i ka të gjitha dyert e hapura që të jemi pjesë e aktiviteteve të Kroacisë", është shprehur Rama. Në kuadër të vizitës në Kosovë, gjenerali kroat Shundov ka vizituar edhe Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.



Kryeministri Haradinaj: Kroacia është partnere strategjike në rajon

Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën ka pritur në takim shefin e shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, gjeneralin Mirko Shundov, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin bilateral në fushën e sigurisë ndërmjet dy vendeve dhe rajonit. Kryeministri ka thënë se marrëdhëniet bilaterale midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë janë aktive dhe miqësore. "Aktualisht kadetë të Forcës së

Sigurisë së Kosovës janë duke u shkolluar në Akademinë Kroate të Mbrojtjes dhe një numër tjetër në kurse trajnuese në fushën e mbrojtjes. Ky bashkëpunim synon të vazhdojë edhe përmes ushtrimeve të përbashkëta, vizitave dhe dialogut në mes të institucioneve të dy vendeve, si dhe këmbimin e informacionit për çështjet e sigurisë rajonale", ka thënë Haradinaj. Ai ka falënderuar Kroacinë për mbështetjen dhe kontributin e dhënë për ndërtimin institucional të strukturave ushtarake dhe të sigurisë në Kosovë.

Kryeministri ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për ta avancuar bashkëpunimin në mes të dy vendeve. "Kosova vlerëson rolin e Kroacisë në integritimin e vendeve të rajonit në strukturat e NATO-s, që do të jetë faktor i fuqishëm për ndërtimin e paqes së përhershme në rajon", ka thënë ai. Gjenerali kroat Mirko Shundov ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritjen dhe gatishmërinë e tij për ta avancuar bashkëpunimin e gjithanshëm në mes të dy vendeve.

Asfaltohet rruga Deçan - kufiri me Malin e Zi

DEÇAN, 11 QERSHOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka marrë pjesë në fillimin e asfaltimit të segmentit të parë të rrugës rajonale R108, Deçan - kufiri me Malin e Zi. Me këtë rast, Lekaj ka theksuar rëndësinë e infrastrukturës rrugore për zhvillimin e turizmit dhe blegtorisë në bjeshkët e Deçanit. Kreu i Infrastrukturës dhe

Transportit ka bërë me dije se shumë shpejt pritet të përfundojnë procedurat tenderuese edhe për fillimin e punimeve në 13 kilometrat e mbetura deri në kufirin me Malin e Zi. Segmenti i parë i rrugës rajonale R108 me gjatësi mbi 14.5 kilometra ka vlerë investive mbi 4 milionë e 190 mijë euro. Asfaltimi i saj do të përfundojë brenda kësaj jave.

Fillimin e asfaltimit e ndoqën nga afër edhe deputetë të zonës, kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ai i Pejës Gazmend Muhaxheri, i Junikut Agron Kuçi dhe kryetari i Rahovecit, Smajl Latifaj. Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, e ka falënderuar ministrin Lekaj për të gjitha investimet infrastrukturore në këtë komunë.



Edi Shukriu shpallet fituese e çmimit letrar 'Beqir Musliu' 2019

GJILAN, 11 QERSHOR (ER) - Shkrimtarja dhe arkeologja Edi Shukriu është shpallur fituese e çmimit letrar "Beqir Musliu", të cilin e ndan kryetari i Komunës së Gjilanit për arritje të veçanta në letërsi. Fituesi është përzgjedhur nga juria e konkursit letrar "Beqir Musliu", në përberje: Ibrahim Kadriu, Sadete Tërnavi Osmani dhe Hasan Bunjaku.

Kryetari Haziri e ka falënderuar jurinë profesionale për punën dhe vlerësimin, ndërsa e ka uruar shkrimtaren dhe arkeolo-

gen Edi Shukriu, për të cilin ka thënë se ka dhënë kontribut të madh në lëmin e letërsisë dhe të arkeologjisë. "Nominimi i sivjetmë i Edi Shukriut i bën nder murit të lavdishëm të çmimit 'Beqir Musliu', pasi veprimtaria e saj, udhëtimi, letrat dhe librat që ajo sot i ka, natyrisht që edhe neve na bëjnë nder. Madhështia e Beqir Musliut nuk është vetëm në libra, por madhështia e tij qëndron edhe në dashurinë dhe përkushtimin që pati gjithmonë për Gjilanin, për Kosovën dhe

për kombin e tij. Por, pa dyshim, ai është përshkruesi më i mirë i Gjilanit në veprat e tij, përshkrim ky që shkon deri në perfeksion", ka thënë Haziri. Ideator i çmimit letrar "Beqir Musliu" është Ars Clubi "Beqir Musliu" nga Gjilani dhe ndahet për herë të trembëdhjetë nga Komuna e Gjilanit. Në fund, kryetari i këtij klubi, shkrimtari Sabit Rustemi, e ka falënderuar kryetarin Haziri që po vazhdon ta nderojë jetën dhe veprën e kolosit të letrave shqipe, Beqir Musliu.



Rrënohen disa objekte pa leje në Qyqavicë

SKENDERAJ, 11 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektoratit, ka filluar të martën rrënimin e objekteve në zonën e Qyqavicës, brenda territorit të kësaj komune, për shkak të mungesës së lejes së ndërtimit. Kryetari i

Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka reaguar pas rrënimit të objekteve pa leje, duke thënë se ligji do të jetë mbi të gjithë. Jashari ka thënë se askush nuk do të lejohet të ndërtojë çfarëdo objekti pa iu nënshtruar procedurave të parapara ligjore, qoftë

në Qyqavicë apo edhe diku tjetër brenda territorit të Komunës së Skenderajt. "Nuk do ta lejojmë degradimin e Qyqavicës për teke të askujt, pjesë e cila është interes i përgjithshëm i komunës", ka thënë Jashari.

14 qershori, ditë pushimi për gjithë punonjësit e Komunës së Rahovecit

Prishtinë, 11 qershor (ER) - Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) nenit 7, paragrafi 2.1, 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, Smajl Latifi, ka marrë vendimin për pushim për të gjithë punonjësit e Komunës së Rahovecit. "Pika 1 e Vendimit thotë se 14 qershori 2019, ditë e premtë, për të gjithë

punonjësit e Komunës së Rahovecit do të jetë ditë pushimi. Pika 2 e Vendimit thotë data 14 qershor 2019, do të jetë ditë pushimi për nder të Ditës së Çlirimit të Rahovecit. Për zbatimin e Vendimit të nënshkruar nga kryetari, do të kujdeset Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Arsim dhe Zyra e Personelit në Komunën e Rahovecit", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Rahovecit.



Përurohen gjashtë rrugë në Tërpezë të Malishevës

MALISHEVË, 11 QERSHOR (ER) - Në vigjilje të shënimit të 16 Qershorit - Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, në fshatin Tërpezë të kësaj komune janë përuar gjashtë rrugë të reja të ndërtuara në këtë fshat. Në ceremoninë e përuimit të këtyre rrugëve ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili i ka uruar banorët e Tërpezës për rrugët. "Pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat e ndërtimit të rrugëve dhe pranimit teknik të punimeve, ne sot, në prag të

shënimit të ditës më të rëndësishme të komunës, po i përurojmë këto rrugë të cilat janë ndërtuar nga buxheti komunal, për banorët e fshatit tuaj. Urime rrugët e reja dhe urime Dita e Çlirimit të Malishevës", ka thënë i Begaj. Rrugët të cilat janë përuar të martën janë rruga "Xhavit Kelmendi", "Selim Elshani", "Alush Rama", "Vezir Kolshi" dhe dy rrugë të reja të cilat ende nuk janë emërtuar. Këto rrugë kanë një gjatësi prej 1 350 metrash dhe janë financuar nga buxheti komunal i Malishevës.



974 zyrtarë të lartë publikë do t'i nënshtrohen kontrollit të pasurisë

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), në prani të mediave dhe shoqërisë civile, ka tërhequr të martë shortin për zyrtarët e lartë publikë që do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë. Sipas shortit, nga 4 862 deklaruës, formularët e 974 zyrtarëve do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë nga ana e AKK-së. Përtej kësaj liste të dalë nga shorti publik, AKK-ja ka mandat ta bëjë kontrollin e plotë të pasurisë edhe të zyrtarëve të tjerë që nuk janë përzgjedhur nga shorti. Agjencia këtë mund ta bëjë sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të publikut apo personave të tjerë të interesuar, në rastet kur ekzistojnë dyshime të bazuara në saktësinë dhe korrektesinë e deklarimeve.

Kontrolli i plotë i pasurisë së deklaruar bëhet në përputhje me Ligjin nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, sipas dispozitave të të cilit, kontrollit



të plotë i nënshtrohen 20 përqind e zyrtarëve që janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre. "Procedura e nxjerrjes së listës për kontrollin e plotë të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë është zhvilluar duke përdorur dy

vazo - në njërin vazo janë vendosur nëntë fleta të palosura të cilat janë tërhequr nga përfaqësuesit e mediave. Vetëm njëra fletëpalosje ka pasur mbishkrimin, 'përzgjedhësi' kurse të tjerat kanë qenë të

zbrazëta. Njëri nga kameramanët tërheqi fletëpalosjen me mbishkrimin 'përzgjedhësi' dhe, sipas procedurës, tërheqi një numër nga vazot dhe dytë ku ishin, po ashtu, të vendosur numrat nga 1 deri në 9 fletë-

palosje. Numri i përzgjedhur ishte 6 dhe për të arritur 20 përqindëshin e listës totale ky numër është rritur për 5 pesë deri në fund të listës 1, 6, 11, 16, 21...", është bërë me dije në njoftimin e AKK-së.

Ministri Shala urdhëron inspektoratin për kontrollimin e hoteleve



PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka lëshuar një urdhëresë që obligon Inspektoratin e ministrisë dhe inspektoratet komunale të bëjnë inspektime nëpër motele duke kontrolluar për mundësinë e mashtrimit të konsumatorit. Shala ka thënë se kjo është duke u bërë në vazhdim dhe mbrojtjes së konsumatorit. "Kam urdhëruar Inspektoratin e Ministrisë së Tregtisë që në koordinim të ngushtë me inspektoratet komunale të marrin një aksion për inspektimin dhe verifikimin e të gjitha dokumenteve si dhe higjienës të secilit motel në Republikën e Kosovës. Këtë

aksion është duke e mbështetur edhe Policia e Kosovës. Ne jemi të përkushtuar që të gjitha shërbimet që ofrohen në Kosovë të kenë cilësi në mënyrë që të mbrohet konsumatori dhe të eliminohet mundësia për mashtrim. Kjo urdhëresë është në vazhdim dhe punës që jemi duke e bërë në mbrojtje të konsumatorit dhe për të vendosur rend dhe rregull", ka thënë ministri Shala. Në këtë aksion është duke asistuar edhe Policia e Kosovës dhe organet e tjera shtetërore. Në urdhëresë obligohen të gjitha inspektoratet që të ndërmarrin veprime kontrolli për të gjitha motelet.

Qeveria miraton nismën për financimin e projektit "Parku Inovativ Trajnues në Prizren"

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka miratuar nismën për financimin e projektit "Parku Inovativ Trajnues në Prizren". Qeveria e Kosovës në mbledhjen e radhës ka miratuar nismën për financimin e projektit "Parku Inovativ Trajnues në Prizren". "Kanë marrë aprovimin e kabi-

netit qeveritar edhe nismat për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për financimin e projektit 'Parku Inovativ Trajnues në Prizren' dhe nisma për marrëveshjen ndërkombëtare me mes të

Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) për bashkëfinancimin e Projektit CETEP+, krijimi i vendeve të reja të punës përmes promovimit të eksportit", është theksuar në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.



GJEOPOLITIKA E MARRËVESHJES KOSOVË - SERBI



Prof. dr. Blerim REKA

Po ta parafrazonim Çerçilin, Ballkani gjithmonë ka prodhuar më shumë probleme sesa që ata mund t'i zgjidhin dhe demonstrimi i fundit i kësaj tendence është paqëndrueshmëria e normalizimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Së fundi, kjo çështje ballkanike po ndikon në mënyrë të habitshme gjeopolitike.

Deri vonë, qe supozuar se ky problem nga fillimi i shekullit 20 do të zgjidhej në dekadën e dytë të 21-të. Por, tri përpjekje të bashkërenduara nga bashkësia ndërkombëtare - bisedimet e Ramboulet (1999), negociatat e Vjenës (2005-2006) dhe Plani i Ahtisaarit (2007) nuk arritën të japin një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët. Dialogu i Brukselit (2012-2019), i ndërmjetësuar nga BE-ja, gjithashtu nuk ka dhënë rezultat. Duket se nuk do të arrihet asnjë marrëveshje deri në fund të këtij viti. Po aq edhe periudha 2020-2021 duket e pashpresë si një datë e përfundimit.

Preferenca të ndryshme

Vendosja e marrëdhënieve normale midis Kosovës dhe Serbisë, që kanë qenë në një gjendje nominale lufte për dy dekada, është më shumë se një çështje dypalëshe apo një problem rajonal. Dimensioi i saj gjeopolitik është dëshmuar më së miri nga pikëpamjet e tre (katër) lojtarëve globalë, secili prej të cilëve duke preferuar një opsion tjetër. ShBA-ja këmbëngul në një zgjidhje paqësore të pranueshme në mënyrë reciproke, që nuk përjashton korigjimimin e kufijve (John Bolton). Rusia është për "çdo zgjidhje që është e pranueshme për Serbinë". BE-ja dëshiron një marrëveshje normalizimi që mund edhe ta lejojë shkëmbimin e territoreve. Megjithatë, Gjermania dhe Franca, tandem

mbizotërues i BE-së, kundërshojnë me ngulm ndryshimet territoriale.

Këto pozicione kontradiktore vetëm sa mund ta komplikojnë kërkimin për një zgjidhje përfundimtare. Ashtu siç gjërat tani qëndrojnë, janë të mundshme tri afate kohore për një marrëveshje të mundshme.

Skenari i parë, afatshkurtër, do të parashihte një zgjidhje para fundit të vitit 2019, por kjo është më pak e mundshme. Sipas skenarit të dytë më të mundshëm, një marrëveshje do të arrihet gjatë dy vjetëve të ardhshëm, përpara fundit të vitit 2021. Skenari i tretë supozon se procesi i normalizimit do të zgjatet përtej vitit 2022, duke e bërë kursin dhe rezultatit e saj të ardhshëm të paparashikueshme.

'Dueti Mercron'

Në të tre skenarët, rivendosja e marrëdhënieve normale midis Kosovës dhe Serbisë trajtohet si një proces multilateral. Kjo u konfirmua nga takimi i fundit joformal i BE-së mbi Ballkanin Perëndimor, në Berlin më 29 prill. Në atë takim kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Macron vendosën ta marrin kontrollin e dialogut të Brukselit, i cili kishte ngecur pothuajse një vit nën ndërmjetësimin e Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini.

Ky hap ishte një qortim i heshur ndaj përpjekjeve të zgjatura të dy komisioneve evropiane dhe shefave të tyre diplomatikë: Catherine Ashton (2012-2014); dhe Mogherini (2014-2019). Takimi i Berlinit shënoi një ndryshim efektiv të lidershit, duke vënë "duetin" e Gjermanisë dhe të Francës në krye të bisedimeve të normalizimit, edhe pse Mogherini mbeti si ndërmjetëse nominale e dialogut.

Negociatat kishin ngecur në mes të vitit 2018, pasi Kosova e akuzoi Serbinë se nuk e zbatoi zotimin e saj sipas Marrëveshjes së Brukselit (2013) për të mos bllokuar anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare, siç

është INTERPOLI. Si hakmarrje, Prishtina shpalli tarifën e importit për produktet serbe në nëntor 2018. Serbia pastaj bojkotoi takimet e mëtejshme të dialogut të Brukselit.

Një arsye tjetër pse Berlinit dhe Parisi dukeshin kritikë në trajtimin e negociatave të Komisionit Evropian, ishte gatishmëria e tij për ta shqyrtuar ndryshimin e mundshëm të kufirit. Kjo ishte anatema ndaj kancelares Merkel dhe presidentit Macron, i ashtuquajtur "Dueti Mercron". Pasi ishte e qartë se bisedimet për normalizim kishin dalë nga kursi, në gusht 2018, presidenti serb Aleksandar Vuçiq shpalli një "plan përfundimtar" që do ta përfshinte shkëmbimin e territoreve me Kosovën. Mogherini ishte pro këtij propozimi, por jo edhe kancelarja Merkel, e cila përsëriti qëndrimin fundamental të Gjermanisë: ndryshimet territoriale në Ballkan janë të papranueshme dhe çdo marrëveshje normalizimi midis dy shteteve duhet t'i respektojë kufijtë ekzistues. Kjo u rikonfirmua kohët e fundit nga Merkeli, më 6 qershor, në takimin e saj me kryeministrin e Kosovës, Haradinaj, në Berlin.

Dështimi i shkëmbimit

Presidenti i Serbisë, Vuçiq, pranoi se takimi i Berlinit qe vdekje e planit të tij për një "marrëveshje kompromisi kufitare". I këtij vlerësimi ishte edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili u tha gazetarëve në fillim të majit se "opsioni i këmbimit të kufijve është historik".

Tash varet nga vazhdimi i iniciativës franko-gjermane, në Paris më 1 korrik, por një ditë pas takimit të Berlinit, presidenti Macron zbuloi strategjinë e re të Francës për Ballkanin Perëndimor. Berlinit pra ishte vetëm stacioni i parë i kësaj nisme të re gjermano-franceze, duke marrë një qasje shumë më të ashpër ndaj procesit të zgjerimit të BE-së në rajon. Mesazhi i hapur për vendet kandidatë ishte se nëse nuk do të jepnin reforma të vërteta dhe të thella në sundimin e ligjit dhe kapitujt e sigurisë të acquis

communautaire, ata mund të presin gjatë për hyrje në Union. Dokumenti francez hasi në pritje të ftohtë në Ballkanin Perëndimor, ku shihej se sinjalizonte që objektivi i shpallur nga Komisioni Evropian në vitin 2025 për anëtarësim nuk ishte më i vlefshëm dhe se data e mundshme e pranimit ishte shtyrë deri në vitin 2030. Kjo do ta ekspozonte Ballkanin Perëndimor në një dekadë tjetër të emigracionit nga të rinjtë dhe të arsimuarit. Ky largim katastrofal i rrurit tashmë i ka kushtuar rajonit 6 milionë njerëz, ose një e treta e popullsisë së saj, sipas një vlerësimi nga Suma Chacrabati, president i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh).

Carnegie Europe ka kritikuar mungesën e një politike të qartë të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor, duke paralajmëruar se kjo neglizhencë mund të çojë në një ndikim më të madh rus dhe kinez në rajon. Kjo e risjell agjendën e sigurisë, për ta parandaluar rajonin drejt rrëshqitjes nga orientimi euroatlantik në alternativa të tjera, si ndikimin rus dhe kinez në rajon.

Jehona e Bizmarkut

Samiti i Berlinit dha dy mesazhe të qarta: 1) Dialogu i Brukselit duhet të rifillojë nga e para; dhe 2) ndryshimi i kufijve duhet të shmanget si pjesë e një zgjidhjeje Kosovë - Serbi. Fare pak mund të pritët nga Bashkimi Evropian gjatë gjashtë muajve të ardhshëm. Pas zgjedhjeve të majit në Parlamentin Evropian, duhet të zgjidhet një komision i ri evropian dhe të zgjidhet një përfaqësues i lartë i ri dhe ndërmjetës për dialogun Kosovë-Serbi. Realisht, Mogherini është në përfundim të mandatit dhe zëvendësimi i saj nuk do të dihet deri në tetor. Për ta shmangur edhe më shumë humbjen e kohës, iniciativa e re franko-gjermane synon që ta kapërcejë këtë pikëpyetje gjatë gjashtë muajve të ardhshëm.

Për vëzhguesit e takimit të Berlinit është e pamundur të injorohen disa jehona që evokohen nga Kongresi i Berlinit i vitit 1878, i organizuar nga paraard-

hësi i saj i shquar Otto von Bismark, atëherë për ta zgjidhur "çështjen lindore". Një shekull e gjysmë më vonë, Evropa ende nuk duket se ka përgjigje të qartë për Ballkanin Perëndimor. Kufijtë e rajonit dhe hartat politike janë ende të paqëndrueshme dhe armiqësitë kombëtare që i vendosin shtetet e saj kundër njëri-tjetrit mbeten të pazgjidhura. Para së gjithash, në vend që të bëhen pjesë e BE-së, rajoni është mbërthyer fort në lindje. Pozicioni i saj mbetet gati i njëjtë si një shekull e gjysmë më parë: një periferi evropiane.

Evropa neglizhente

Pas Berlinit, bisedimet e normalizimit të drejtuara nga dueti do të vazhdojnë: këtë verë në Paris, pastaj në Poloni me raundin e gjashtë të Procesit të Berlinit. Përfundimisht, ka të ngjarë që në fund të vitit të ketë edhe një takim tjetër në Uashington - vetëm nëse Prishtina dhe Beogradi do të arrijnë një marrëveshje.

Realizimi i skenarit të parë dhe afatshkurtër do ta kërkonte arritjen e një zgjidhjeje mes Kosovës dhe Serbisë gjatë kësaj periudhe shtatëmuajore. Kjo është një kohë tejet e shkurtër për të zgjidhur një mosmarrëveshje të tillë të komplikuar. Është, gjithashtu, një periudhë tepër e shkurtër për të arritur një konsensus midis interesave ndërkombëtare konkurruese, sidomos Evropës, Ruisë dhe ShBA-së.

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tashmë ka ftuar homologun kosovar dhe atë serb, presidentët Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq, në Shtëpinë e Bardhë nëse dhe kur do të arrijnë një marrëveshje përfundimtare. Kjo ofertë tashmë është përshkruar si një marrëveshje e re "Camp David" për paqen e Ballkanit, e ngjashme me atë të arritur katër dekada më parë midis Izraelit dhe Egjiptit. Por, vëzhguesit e zellshëm kanë vënë në dukje se ftesa e presidentit Trump mund të ketë luajtur një rol edhe në nismën e re të Ballkanit, të nisur nga Merkeli dhe Macroni.

Jo vetëm një reagim ndaj përparimit të ngadaltë të dialogut

të Brukselit, demarshi i Bedrlinit, mund të interpretohet gjithashtu edhe si një mesazh për Uashington se dy fuqitë më të mëdha të Evropës nuk do të shpërfillen në çështjet e Ballkanit. Për kancelaren Merkel, një marrëveshje e paqes mund të ishte arritja e saj e fundit ndërkombëtare derisa është në detyrë, duke pasur parasysh vendimin e saj për të dhënë dorëheqje deri në fund të vitit 2020. Për presidentin Macron, ndërmjetësimi i suksesshëm do ta rriste reputacionin e tij ndërkombëtar, i cili kohët e fundit është prekur nga përmbajtjet në Libi. Gjithashtu, kjo do ta promovojë vizionin e tij të ri për BE-në, i cili e sheh bllokun duke thelluar integrimin e saj përpara zgjerimit të mëtejshëm

ShBA-ja dhe Rusia

Sa iu përket lojtarëve të tjerë të rëndësishëm, ShBA-ja është duke u përgatitur për zgjedhjet presidenciale në vitin 2020, ndërsa presidenti rus Vladimir Putin do ta arrijë mesin e mandatit të tij përfundimtar presidencial. Nuk kishte asnjë tregues të menjëhershëm se mosmarrëveshjet Kosovë - Serbi u përmendën në takimin në fillim të majit midis sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo dhe ministrit të Jashtëm rus Sergei Lavrov. Me tensionet midis dy shteteve për: Venezuelën, Ukrainën, Sirinë dhe dyshimet për ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet e ShBA-së, Ballkani Perëndimor mund të jetë vënë në rend të dytë të administratës së Trumpit. Kjo do ta shtyjë sqarimin e nevojshëm të pozicionit amerikan për sigurinë e Evropës Juglindore

Rusia, nga ana tjetër, mbetet e interesuar në mënyrë intensive në rajon. Trajtimi i saj ndaj mosmarrëveshjeve Serbi - Kosovë duket i njëjtë me qasjen e saj ndaj kontestit 27-vjeçar midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, e cila përfundoi këtë vit pasi parlamentet e të dy vendeve ratifikuan marrëveshjen e Prespës në qershor 2018. Në këtë rast, Moskë vazhdimisht u pozicionua me Greqinë duke kundërshtuar anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Tani Rusia është avokatja kryesore e Serbisë në përpjekjet për ta bllokuar anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara, INTERPOL dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Herët apo vonë?

Për të gjitha pengesat e përmendura më lart është e habitshme se lehtë mund të arrihet një kompromis midis Kosovës dhe Serbisë, por diçka edhe mund të lëvizë. Në fazën e parë, ajo do të mund të ishte një shkëmbim i thjeshtë: OKB-ja për BE-në.

Beogradi do të mund të heqë dorë nga kundërshtimet e veta ndaj Kosovës duke fituar një vend në OKB, ndërsa Prishtina do të pohonte që marrëdhëniet me Serbinë ishin bërë mjaftueshëm "të normalizuara" për ta zhblokuar Kapitullin 35 (që ka të bëjë me Kosovën) të negociatave të Serbisë në BE. Kjo ende nuk do të përbënte një zgjidhje gjithëpërfshirëse të paqes ose rivendosjen e marrëdhënies të plota diplomatike, por do të ishte një pazar fer fillestar.

E vetmja mënyrë që ky skenar të bëhet i realizueshëm është me mbështetjen e plotë të duetit franko-gjerman, (për të fituar mbështetje në Këshillin e Evropës dhe një konsensusi të ShBA-së dhe Rusisë, për të kapërcyer çdo kundërshtim në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Për të fituar një moment diplomatik, Merkel dhe Macroni do të duhej ta detyronin Prishtinën dhe Beogradin për dy vendime të shpejta: heqjen e tarifave të Kosovës ndaj mallrave serbe dhe tërheqjen e kundërshtimeve të Serbisë ndaj anëtarësimin të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Nëse këta hapa nuk ndodhin brenda dy ose tre muajve të ardhshëm, do të humbet shansi për një zgjidhje afatshkurtër.

Data e synuar 2020-2021 për normalizimin e plotë është thjesht për shkak të afatit dyvjeçar. Kjo u jep më shumë kohë jo vetëm politikanëve në Kosovë dhe Serbi, por edhe në mesin e lojtarëve të mëdhenj. ShBA-ja, Rusia dhe BE-ja do të kenë mundësi më të mëdha për t'i zgjidhur prioritetet e tyre rajonale, nga Ukraina në Ballkan dhe Lindjen e Mesme. Kancelarja Merkel sigurisht do të donte ta mbyllte karrierën politike me një triumf diplomatik, edhe pse do të ishte vështirë të pritej që presidenti Trump, në mes të një fushate të ashpër për rizgjedhje, t'i kushtonte më shumë kohë Ballkanit Perëndimor.

Gjërat bëhen më të komplikuar në qoftë se zgjidhja përfundimtare shtyhet përtej vitit 2021. Konfliktet ballkanike rrallë përmirësohen kur lejohet që ato të zbehen. Më e rëndësishme, me kalimin e kohës, shanset e rritjes së ndryshimeve të liderit me shumicë jo vetëm në BE dhe në ShBA, por edhe në Serbi, Kosovë dhe, madje, edhe në Rusi. Presidenti Thaçi në Kosovë dhe presidenti Vuçiq në Serbi përfundojnë mandatet e tyre në 2021, respektivisht më 2022. Krerët e rinj të shtetit mund të kenë agjenda të ndryshme ose kanë nevojë për kohë shtesë për të zotëruar çështje që i kanë penguar paraardhësit e tyre.

(Botuar në Geopolitical Intelligence Service. Përkthet nga anglishtja: Arsim Osmani)

JO SI 'PARAMILITARË'! IVICA DAÇIQI ËSHTË PËRFAQËSUES I DENJË I SHTETIT QË KREU GJENOCID NË KOSOVË

Nocioni "paramilitar", qoftë kur i atribuohet një individ, qoftë kur i drejtohet një grupi, prezanton individin ose struktura jashtë forcave të armatosura të një shteti. Ky nocion është shndërruar në instrument të manipulimit me opinionin publik në funksion të fshehjes së përgjegjësisë së strukturave politike dhe ushtarake të një shteti në kryerjen e krimeve të caktuara, dhe pikërisht për këtë arsye propaganda serbe e futi në përdorim termin "paramilitar".



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Pas mbledhjes së djeshme të Këshillit të Sigurimit, ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiq, shkaktoi skandal të rëndë diplomatik kur fyeu rëndë diplomatët e shteteve perëndimore dhe ambasadorin e Kosovës. Arroganca e Ivica Daçiqit ka mundur të befasojë ndonjë nga diplomatët e shteteve perëndimore që nuk e kanë ditur rrugëtimin politik të këtij "diplomatit". Kjo sjellje nuk paraqet asnjë befasi për ata që e dinë se Ivica Daçiqi është kuadër politik i formuar dhe edukuar në frymën e njëjtë si të Sllobodan Millosheviqit; ai ishte person i privilegjuar i Sllobodan Millosheviqit, të cilit Kasapi i Ballkanit ia kishte besuar funksionin e zëdhënësit të partisë së tij. Në të gjitha funksionet që ka ushtruar, gjatë luftës dhe pas përfundimit të saj, Ivica Daçiqi ka prezantuar në mënyrë më të denjë politikën e shtetit serb, sidomos është dëshmuar si zëdhënës i politikës së fshehjes së gjurmëve të gjenocidit kundër shqiptarëve në Kosovë. Fatkeqësisht një gazetar, i cili nuk i ka njohuritë e nevojshme teorike për implikimin e termit "paramilitar", publikoi shkrimin e titulluar "Daçiqi sil-

fashistë) si dhe historianë e politologë, filozofë e sociologë, gazetarë e publicistë, të orientimit të djathtë e të majtë. Fatkeqësisht, edhe në diskursin tonë politik dhe mediatik nocioni "grupe paramilitare" ka zënë një vend të rëndësishëm, pa menduar për pasojat e mëdha që sjell përdorimi i këtij termi në shfaqësimin e shtetit serb për krimin e gjenocidit.

Gjatë luftës në Kosovë nuk ka pasur "paramilitarë". Çdo gjë ka qenë e kontrolluar në detaje. Gjenocidin në Kosovë e kreu Serbia përmes forcave të saj të armatosura me një zinxhir të qartë komandues nga institucionet politike, ushtarake dhe policore të shtetit serb.

Është e kuptueshme që pushteti i Serbisë, qoftë i kohës së Millosheviqit, i Tadiqit apo i Vuçiqit dhe Daçiqit, aplikon strategjinë e mohimit të krimit të gjenocidit të kryer në Kosovë. Gjithashtu, është e kuptueshme përpjekja e tyre për ta zhvendosur fajësinë nga shteti serb te "grupet paramilitare të pakontrolluara nga shteti serb". Por, nuk është e drejtë që politikanë dhe gazetarë shqiptarë, në mënyrë të pavetëdijshme për pasojat që ka përdorimi i këtij termi, ta përdorin nocionin "paramilitar".

Fatkeqësia është edhe më e madhe kur nga padituria e asaj çka fshihet prapa përdorimit të këtij termi, duke përdorur cilësimin "paramilitarë" për ata që kanë qenë të përfshirë në krime dhe në fshehje të krimeve, politikanë dhe gazetarë mendojnë se i paraqesin edhe më të këqij.

Realisht është e kundërta. Në mënyrë të pavetëdijshme bëhet shfaqësimi i shtetit që përpiloi, zbatoi dhe u përpoq ta fshehtë krimin e gjenocidit.

P. s.:

Më gjerësisht për këtë çështje kam shkruar në shkrimin e titulluar "Nocioni 'paramilitar' si instrument i mohimit të gjenocidit", të cilit i kanë dhënë një hapësirë të konsiderueshme mediat në Kosovë.

Macron: Bota është në krizë të thellë

GJENEVË, 11 QERSHOR - Bota po kalon në një krizë të thellë, dhe mund të jetë në prag të një kohe të luftës, tha presidenti i Francës, Emmanuel Macron gjatë një fjalimi të mbajtur të martën në Gjenevë.

"Unë besoj se sot ne jemi në prag të një kohe lufte dhe kjo luftë është e pranishme në demokracitë tona, është kriza e thellë që po kalojmë. Ne mund të zgjedhim të

jemi somnambul, por nëse duam përparim të vërtetë, ne duhet të bëjmë angazhime serioze", tha ai.

Macroni bëri thirrje për një përpjekje botërore, në adresimin e kërcënimeve siç janë: pabarazia, ndryshimet teknologjike dhe ato klimatike.

"Unë mendoj se kaosi është këtu dhe është përgjegjësia e brezit tonë që të mos presim për një

luftë të re, por të shohim gjendjen në botë ashtu siç është", tha Macroni.

Presidenti 41-vjeçar i Francës, e ka vënë veten në ballë të një lëvizjeje liberale duke kundërshtuar ngritjen e së djathtës në Evropë. Pozicioni i tij brenda Francës është dëmtuar, nga protestat disamujshme kundër reformave ekonomike, duke përfshirë një taksë të karburantit.



Pompeo mbron marrëveshjen ShBA-Meksikë për të shmangur tarifafat

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo tha se problemi i emigrantëve të Amerikës Qendrore drejt kufirit jugor të Shteteve të Bashkuara është trajtuar në një mënyrë të re, në një marrëveshje që pasqyron diplomacinë në rolin e saj më të mirë

WASHINGTON, 11 QERSHOR - Sekretari i Shtetit Mike Pompeo po mbron marrëveshjen e administratës Trump me Meksikën për të frenuar rrjedhën e emigrantëve të Amerikës Qendrore në kufirin SHBA-Meksikë dhe për të shmangur tarifafat ndëshkuese për Meksikën, me të cilat kërcënoi presidenti Donald Trump. Kritikët thonë se marrëveshja e së premtes nuk sjell ndonjë të re dhe se iniciativat tashmë po diskutoheshin përpara kërcënimeve të presidentit lidhur me vendosjen e tarifave.

Problemi i emigrantëve të Amerikës Qendrore drejt kufirit jugor të Shteteve të Bashkuara është trajtuar në një mënyrë të re, thotë Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, në një marrëveshje që

"pasqyron diplomacinë në rolin e saj më të mirë".

"Ata që kalojnë kufirin jugor të Shteteve të Bashkuara për të kërkuar azil do të kthehen menjëherë në Meksikë, ku mund të presin vendimin ndaj aplikimeve të tyre për azil. Kjo është praktikuar edhe më parë; kemi qenë në gjendje ta bëjmë këtë për disa qindra njerëzve në ditë. Tani do të kemi aftësinë ta bëjmë këtë për të gjithë, në një mënyrë që do të sjellë një ndryshim thelbësor për ata që vendosin të kalojnë Meksikën në përpjekje për të hyrë në Shtetet e Bashkuara tha ai.

I pyetur se si kjo marrëveshje është e ndryshme nga negociatat e mëparshme, sekretari Pompeo tha se hapësira e marrëveshjes dhe angazhimi nga



Meksika këtë herë janë të ndryshme dhe se kjo marrëveshje nuk do të kishte ndodhur pa kërcënimin e tarifave të presidentit.

"Ne presim të shohim një pakësim të ndjeshëm të numrit të emigrantëve në javët dhe muajt e ardhshëm dhe unë do të thosha se qeveria mexikane

ishte tepër e sigurt, se veprimet që po ndërmerre do të sillnin zvogëlim të madh të numrit të emigrantëve", tha zëdhënësi i Departamentit të Shtetit Morgan Ortagus.

Në Shtëpinë e Bardhë, një gazetar e pyeti presidentin Donald Trump për atë që ai e quajti një "marrëveshje të fshehtë" shtesë

me Meksikën - pasi ministri i Jashtëm mexikan Marcelo Ebrard tha se nuk ka marrëveshje përtej asaj që u tha në detaje të premtën.

"Kemi një marrëveshje për diçka që ata do ta shpallin shumë shpejt. Është bërë e gjitha. Ata duhet të marrin miratimin e parlamentit, dhe do ta marrin atë. Nëse nuk e marrin miratimin, do të duhet të mendojmë për tarifafat apo çfarëdo qoftë. Është vetëm një aspekt tjetër i asaj që kemi arritur. Kjo u bë e gjitha për shkak të tarifave dhe të marrëdhënies që kemi me Meksikën. Kam biseduar dje me presidentin", tha ai.

Në një deklaratë të përbashkët me Shtetet e Bashkuara të premtën, Meksika tha se do të vendosë 6,000 anëtarë të Gardës Kombëtare përgjatë kufirit të saj jugor me Guatemalën dhe se të dy vendet do të shqyrtojnë suksesin e veprimeve brenda 45 ditëve. Tarifafat do të kishin filluar të hënën, por presidenti Trump i pezulloi ato për një afat të pacaktuar.

Ministrat e 13 vendeve të BE-së mbështesin integrimin e Ballkanit

BRUKSEL, 11 QERSHOR - Ministrat e jashtëm të 13 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, përmes një deklaratë të përbashkët, kanë përsëritur mbështetjen e vazhdueshme për procesin e integritimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Në deklaratë, i bëhet thirrje Këshillit të Bashkimit Evropian, që në takimin e qershorit, të



marrë vendim për hapjen e negociatave për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

"Fillimi i negociatave në qershor

të vitit 2019 do të kontribuojë në forcimin e qëndrueshmërisë së vendeve ndaj interesave të jashtme, dhe të dëmshme, të aktorëve të tjerë, dhe do të sigurojë që BE-ja do të vazhdojë të jetë lojtari kryesor për një transformim pozitiv të rajonit", thuhet në deklaratë.

Shefat e diplomacisë së 13 vendeve anëtare të BE-së, theksojnë se është thelbësore të

vazhdohet me procesin e integritimit të Ballkanit Perëndimor, dhe sipas tyre, krahas me këtë proces, nuk ekziston plani B.

"Është thelbësore për të siguruar përparimin e përgjithshëm të rajonit. BE-ja duhet të përmblushë angazhimin e saj të qartë për integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor. Nuk ka plan B", thuhet në deklaratë.

Deklarata është nënshkruar nga

ministrat e Jashtëm të Çekisë, Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Hungarisë, Bullgarisë, Italisë, Polonisë, Maltës, Austrisë, Kroacisë, Sllovenisë dhe Sllovakisë.

Kjo deklaratë vjen në kohën kur vendet anëtare të BE-së janë të ndara sa i përket hapjes së negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.


Moska ende e pavendosur për takimin Trump-Putin

MOSKË, 11 QERSHOR - Moska tha se ende nuk është vendosur nëse presidenti i Rusisë, Vladimir Putin do të takohet me presidentin e SHBA-së, Donald Trump në samitin G20, që do të mbahet në Japoni, gjatë këtij muaji. Presidenti Trump duket se e ka zënë

në befasi administratën ruse kur tha se planifikonte të takonte Putinin gjatë samitit të 20 vendeve më të zhvilluara të botës, raporton Reuters.

Këshilltari i presidentit rus, Yuri Ushakov, u tha gazetarëve se Moska është e hapur dhe shpreson se takimi

do të ndodhë, mirëpo shtoi se një ide e tillë ende qëndron "pezull". Të dyja vendet kanë mosmarrëveshje dhe tensione sa i përket Sirisë, përfshirjes ruse në Ukrainë dhe ndërhyrjes në zgjedhjet e SHBA-së, gjë të cilën Moska e mohon.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E rrallë

Bie 244 metra brenda në vullkan, shpëton mrekullisht burri

Një person është shpëtuar pasi u rrëzuar të hënën në liqenin Crater në Oregon, një vullkan i fjetur. Burri ra rreth 244 metra brenda në kraterin e madh vullkanik pranë fshatit Rims,



kanë njoftuar rojet bregdetare të ShBA-së. Ekípet e shpëtimit zbritën 182 metra në krater dhe shpëtuan atë.

BARSOLETA E DITËS



Dy shokë:

- A bën të di pse s'je martuar deri tash?
- Femrat që i çoja në shtëpi s'i pëlqenin nënës.
- Gjëje një si nëna jote dhe dërgoje në shtëpi.
- E pata gjetur një si nëna, por baba na përzuri nga shtëpia.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



FOTO E DITES



Ish-presidenti i ShBA-ve, Bill Clinton, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", me rastin e vizitës së tij për nder të 20-vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë.

Ne ora 16:00 dhe 19:00 "AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



E jashtëzakonshme

"Kisha e kockave" u ndërtua nga 40 000 skelete njerëzish

Në zemër të fshatit çek, Kutna Hora strehon disa prej arkitekturave më të bukura në të gjithë Boheminë. Pozicionuar rreth 70 kilometra në lindje të Pragës, vendi mesjetar shfaq një vizion mbresëlënës të kulturës dhe traditës çeke. 'Kisha e Gjithë Shenjtorëve' ka një histori mjaft tërheqëse.



Poshtë një shkalle të vogël, në dhomën më të ulët të kësaj kisha katolike, shtrihet Ossuary Sedlec, i cili zbukurohet me rreth 40 000 skelete njerëzore.



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Jeni duke ndjekur të njëjtën rrugë prej kohësh kështu që do ta kuptoni nëse jeni në drejtimin e duhur që në fillim.</p>	 <p>DEMI Nëse keni ndihmën e personave të duhur do të zhvilloni një projekt mjaft të bukur për të gjithë ju. Në fillim do t'ju shohin mosbesues.</p>	 <p>BINJAKËT Ndjenjat tuaja do t'ju ftojnë sot t'i jepni një shans të dytë një personi special për ju, por qe ju ka zhgënjyer në një moment të caktuar.</p>	 <p>GAFORRJA Po e kërkoni ngado lumturinë tuaj dhe akoma nuk e keni kuptuar që e keni shumë pranë vetes. E rëndësishme është t'i jepni vëmendjen e duhur.</p>	 <p>LUANI Nuk po e merrni si duhet një sfidë që ju kanë hedhur sot. Mendoni se mund të jetë e thjeshtë, por në fund të ditës do të gjendeni keq.</p>	 <p>VIRGJERESHA E shihni që keni marrë një sjellje të ndryshme karshi një miku që ka ndarë çdo gjë me ju. Jeni kondicionuar nga sa keni dëgjuar kohët e fundit.</p>
 <p>PESHORJA Edhe pse shumë persona ju shprehin me fjalë suportin e tyre ju e dini që e thonë në mënyrë sipërfaqësore. Janë shumë pak ata që e ndjejnë vërtet.</p>	 <p>AKREPI Duhet të rikuperoni kohën e humbur sot duke u angazhuar në të gjithë projektet që i keni lënë pas dore. Kërkoni ndihmë nëse keni nevojë.</p>	 <p>SHIGJETARI Gjëra të mëdha do të ndodhin për të cilat deri dje nuk kishit shpresë se mund të realizoheshin. Partneri shumë i përkushtuar karshi jush.</p>	 <p>BRICJAPI Nëse nuk doni t'u besoni personave që keni pranë të paktën besojini intuitës tuaj dhe mënyrës së organizimit të gjërave. Do t'ju shpëtojnë në moment të fundit.</p>	 <p>UJORI Sot do të ekzagjeroni disi me paranojat tuaja. Jo çdokush e ka me ju dhe jo çdokush dëshiron t'ju pengojë. Stresi i ditëve të fundit ju ka mposhtur.</p>	 <p>PESHQIT Është e udhës që sot të mos irritoni asnjë me sjelljet tuaja. Mbase ju nuk e kuptoni kur mund të lëndoni të tjerët pa shkak.</p>

Usher bën tatuazh gjigant prapa kokës



Artisti i tatuazheve Dillon Forte ka zbuluar tatun e mahnitshme të Usherit. "Kam pasur kënaqësinë të bëj tatuazh për legendën Usher", ka shkruar Dillon në llogarinë e vet në "Instagram". Punimi zgjati rreth tre orë. Dillon iu ka bërë edhe të famshmëve të tjerë tatuazhe përfshirë Chris Hemsworth, Kat Von D dhe të tjerë.




Rihanna bën një trend të ri të thonjve



Përderisa shumë të famshëm kanë atë lloj ndikimi të krijuar një trend të flokëve apo ta heqin një tjetër, Rihanna ka atë ndikim të rrallë që të krijojë një trend interesant të thonjve me vetëm një postim në "Instagram".

Ajo ka treguar një manikyr ngjyrë vjollce dhe hiri të përzier bashkë. Rihanna gjithmonë është aty që t'i bëjë gjërat interesante dhe tani ajo vendosi ta përziejë këtë manikyr të gjelbër me një ngjyrë lavandre të artit.



Shakira dhe Alejandro Sanz ribashkohen në Barcelonë për të performuar 'La Tortura'

Shakira dhe Alejandro Sanz kanë qenë shokë për një kohë të gjatë, por pas publikimit të hitit të tyre "La Tortura" kaloi në tjetër nivel. Alejandro Sanz u ndalua në Barcelona, ku ylli spanjoll është duke përgatitur një surprizë të madhe për të

gjithë fansat. Ai ftoi Shakirën ta performojë këngën e tyre "La Tortura". "Ajo është një nga ata miqtë, të cilët, me afërsinë e saj, ndryshojnë fjalën e shpirtit tim dhe nëse mund të kërkoj një dëshirë për këtë koncert, do të këndoja me të", ka thënë Sanz.

Jonah Hill në darkë romantike me të dashurën

Jonah Hill dhe Gianna Santos janë parë sërisht bashkë. Aktori 35-vjeçar dhe e dashura e tij u panë duke u shëtitur pas një darke në Nobu, në Malibu. Jonah kishte të veshur një xhakëtë prej xhin-si, ndërkaq Gianna xhinse me një bluzë të zezë. Muajin e kaluar, Jonah Hill, mbështeti motrën e tij Beanie Feldstein në premierën e filmit "Booksmart".



Ekspozitë për Lidhjen e Prizrenit

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave ka çelur dje ekspozitën "Lidhja e Prizrenit 1878-2019 mes dokumenteve të Arkivit Qendror Shtetëror".


Më 10 qershor 1878 u mbajt në Prizren, Lidhja e Prizrenit, e cila ishte lëvizja e parë e shqiptare e madhe e organizuar në mënyrë administrative, politike, ushtarake. Shqiptarët thirrën një Kuvend mbarëkombëtar, ku do të merreshin vendime shumë me rëndësi për vendin. Pas firmosjes së marrëveshjes të Shën Stefanit mes Rusisë dhe Turqisë, ku Shqipërisë nuk iu njoh asnjë e drejtë territoriale dhe në pritje të Kongresit të Berlinit, i cili me shumë mundësi do t'i hiqte hartës shqiptare krahina të shumta, atdhetarët shqiptarë ideuan këtë mbledhje, ku do të shpallnin ndarjen përfundimtare nga sundimi osman. Kuvendi priti delegatët pa dallim feje, ata do të vinin nga të katërt Vilajetet e Shqipërisë: Shkodrës, Manastirit, Janinës dhe Kosovës. Lidhja e Prizrenit, zgjati 5 ditë dhe numri i delegatëve shkoi në 110, ku mes tyre ishin Ahmet Koronica, Abdullah Pashë Dreni, Shaban Prizreni, Zija Prishtina, Filip Doda, Sulejman Vokshi, Shuajip Spahiu, Ali Ibra, Abdyl Frashëri, e shumë të tjerë, duke zgjedhur si kryetar anëtarin më të vjetër i cili kishte dhe fuqi të madhe morale, Iljaz Pashë Dibrën.

Në mbledhjen e datës 10 qershor 1878 u mbajtën fjalime nga delegatë të ndryshëm, një prej të cilëve dhe Abdyl Frashëri ku ndër të tjera tha: "Ne Shqiptarët rrjedhim nga

Pellazgët e jemi populli ma i vjetër këtu në Ballkan kurse sllavët erdhën vonë e duke qenë në shumicë të madhe na shtynë në Jug-Perëndim të Ballkanit në këtë rrype të ngushtë ku ndodhemi sot. Nuk qe mjaft grabitja që na banë atëherë po kërkojnë sot me na shkitë edhe tokë të tjera. Kta na kërkojnë Plavë e Guci e Grekët një copë të Vilajetit të Janinës e cila asht pjesë e pa-ndame e Atdheut tonë të dashun.

"Qëllimi i kësaj mbledhjeje sot asht me u-a pre hovin ktyne anmiqve të pa-shpirtë, duke lidhë besën shqiptare e duke u-betue me i mbrojtë me gjak trojet që na kanë lanë gjyshët dhe katragjyshët t'onë".

Motoja e kësaj mbledhjeje ishte: "Të luftojmë deri sa të derdhim pikën e fundit të gjakut. Para interesit t'atdheut të ç'duken interesat private". Delegatët para së gjithave shihnin të rëndësishëm sigurimin e qetësisë dhe të zhdukjes së gjakmarrjes dhe nëse jo përgjithnjë, të paktën deri sa të rregullohej situata e Shqipërisë. Lidhja e Prizrenit vepronte njësoj si një qeveri kombëtare, duke sunduar dhe rregulluar krahinat e qytetet e Shqipërisë për sa i përket administratës, gjithashtu mbledhte luftëtarë edhe taksa. Dy vendimet e para që mori Lidhja e Prizrenit ishin një peticion nisur Kongresit të Berlinit dhe një tjetër perandorisë osmane. Në këto vendime i bënin të qartë se Shqipëria nuk mund të jepte asnjë pëllëmbë tokë nga viset e saj, të shoqëruara më dhjetëra firma nga delegatët pjesëmarrës



Anëtarë të Lidhjes së Prizrenit

Anëtarë të Lidhjes së Prizrenit

Rregullorja e Lidhjes së Prizrenit bashkë me nënshkrimet e delegatëve. 20 haziran 1294 / 2 Korrik 1878

1939/ Hitleri kishte një dhuratë për Mbretin Zog, Musolini i prishi planin

"La Charente" ka botuar, të hënën e 19 qershorit 1939, në faqen n°2, një shkrim në lidhje me fatin e kurorës së Skënderbeut, të cilin, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut "Dars (Klos), Mat - Albania", e ka sjellë për publikun shqiptar:

Musolini i kërkoi Hitlerit kurorën e vërtetë të mbretërve të Shqipërisë që gjendet në Gjermani

Lexime

NGA AURENC BEBJA

"La Charente" ka botuar, të hënën e 19 qershorit 1939, në faqen n°2, një shkrim në lidhje me fatin e kurorës së Skënderbeut, të cilin, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut "Dars (Klos), Mat - Albania", e ka sjellë për publikun shqiptar:

Musolini i kërkoi Hitlerit kurorën e vërtetë të mbretërve të Shqipërisë që gjendet në Gjermani

"Mes shumë bizhuterive që



nazistët, pas Anschluss-it, gjetën në Vjenë, bën pjesë edhe kurora unike dhe e vërtetë e Shqipërisë, të cilën Hitleri e ka transportuar tashmë në Gjermani.

Vitin e kaluar, me rastin dhjetë vjetorit (jubileut) të mbretit Zog, Hitleri kishte përgatitur gjithçka, për t'i "dhuruar" këtë kurorë.

Por Musolini, i cili padyshim kishte idenë e tij, kërkoi të shtyjë këtë operacion, dhe Zogu nuk e mori kurorën e tij të vërtetë. Disa javë më parë, Italia kërkoi nga Fyhreri që t'i dërgonte emblemat shqiptare mbretit Viktor Emanuel, në mënyrë që kurorëzimi të bëhej me të gjithë shkëlqimin e dëshiruar."



Kryevepra e humbur e Davinçit përfundon në jahtin e sheikut



Portreti më i kushtueshëm në histori, "Salvator Mundi", gjurmët e të cilit humbën në mënyrë misterioze gjatë një shitjeje në ankand nga Christie's në 2017 në Nju Jork, kanë përfunduar në një

jaht gjigand. Sipas faqes ArtNet.com piktura, e cila dyshohet se i dedikohet Leonardo Da Vinci, është në pronësi të princit trashëgimtar saudit, Muhammed bin Salman.

Një tjetër princ saudit, Bader bin Abdullah bin Mohammed bin Farhan al-Saud, mendohet të ketë blerë portretin për llogari të Salman në shifrën stratosferike të 450 milion dollarëve. Jahti i të

fortit të Riad gjendet në detin e kuq në liqenin e Sharm El Sheik, sipas informacioneve të mbledhura nga agjensia 'Bloomberg'. ArtNet pretendon se 'Salvator Mundi' do të qëndrojë në bordin

e 'Serene' deri në fund të inaugurimit të një ekspozite që sauditët pretendojnë të krijojnë në rajonin e Al Ula. Projekti dyshohet të jetë akoma në fazat elementare.

Restaurimi kushtoi 1,5 mln euro. Anija e shekullit të 19 përfundon sërish nën ujë

Sapo i ishte nënshtruar një restaurimi të shtrenjtë dhe lëshimi i saj në ujë pritej me shumë kërshëri; por nuk që e thënë që anija e shekullit të 19-të e pagëzuar "No 5 Elbe", të shkëlqente sërish.

Ajo u fundos menjëherë pas përplasjes me një anije tregtare, incident ky që shkaktoi edhe disa të lënduar. Ngjarja ndodhi në ujërat e lumit të Elbës, në Hamburg.

43 personat në bordin e saj u arrit të evakoheshin në kohë vetëm falë anijeve të tjera në zonë. "No 5 Elbe", e ndërtuar në 1883-shin, ishte mjeti i fundit lundruar i drunjtit në Hamburg

që daton prej asaj periudhe.

"Po të mos ishin ato në afërsi, do të kishte pasur viktima", tha shefi i zjarrfikësve Wilfried Sprekels, duke iu referuar pranisë së anijeve të shpëtimit, të cilat rastisen aty për shkak të një incidenti të mëparshëm dhe më të vogël në zonë.

Njerëzit u shpëtuan, megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të mëdha, anija e rrallë u mbulua nga uji. Restaurimi i porsapërfunduar i saj në një kantier detar danez kishte kushtuar plot 1,5 milionë euro. Shpresat ishin që anija të jepej me qira për shëtitje turistike.



Si e parashikon inteligjenca artificiale suksesin e aktorëve

Matematika arrin të parashikojë nëse një aktor do të ketë sukses apo jo, sipas një studimi të publikuar në revistën, "Nature Communications" nga grupi i Universitetit "Queen Mary" në Londër.

Kjo është e mundur falë inteligjencës artificiale dhe analizimit të të dhënave mbi karrierën e më shumë se një milionë e gjysmë aktorë dhe rreth 900 000 aktoreve nga e gjithë bota, nga origjina e kinemasë deri në vitin 2016, që ndodhen në bankën botërore të të dhënave për filma, "Internet Movie Database" (IMDb).

Analizimi i të dhënave mundëson që të përcaktohet se kur do të jetë viti më produktiv në karrierën e një aktori apo të një aktoreje dhe të vlerësojë me një saktësi prej 85%, nëse karriera e tyre ka arritur apo jo kulmin.

"Ky studim po tërheq shumë vëmendjen e industrisë kinematografike, në pikën që, kemi zbuluar se një skenarist është i interesuar të shkruaj një dorëshkrim bazuar pjesërisht mbi këto të dhëna", thotë Lucas Lacasa, një prej autorëve të këtij studimi.



Për një orë gjumë që mungon...ja pasojat!

Mungesa e gjumit është një ndjesi padyshim e pakëndëshme për këdo që i bie rasti ta përjetojë. Ditët kur zgjoheni të lodhur dhe me vështirësi nga krevati juaj me siguri i mbani mend. Ndodh të ndjeni vështirësi në fokusim, irritim të shpejtë apo trubullim të mendimeve si pasojë e mungesës së gjumit të mirë.

Në këtë mënyrë edhe rutina e përditshme kthehet në një sfidë e vërtetë, pasi ndiheni vazhdimisht të lodhur. Prandaj rëndësia e një gjumi të qetë dhe të mirë është një domosdoshmëri për funksionimin e metabolizmit. Po si ndikon gjumi në shëndet? Shumë studime kanë treguar se gjumi i mirë është një faktor kyç në parandalimin e sëmundjeve.

Simptoma të tilla si presioni i lartë i gjakut, obeziteti apo kolesterolit. Një studim i fundit, publikuar në revistën Diabetes Care nga Instituti Kombëtar i Shëndetit në SHBA, shpjegon për problemet që mungesa e gjumit shkakton në organizëm. Mungesa e këtij procesi të rëndësishëm mund të shkaktojë një gjendje shqetësuese për trupin që quhet sindroma Metabolike.



Do të thotë që metabolizmi po zhvillon një sërë sëmundjesh kronike duke filluar që nga

diabeti i tipit 2. Ekspertët morën në studim për këtë fakt rreth 2000 persona nga moshë


45 deri në 84 vjeç. Të dhënat nga këta persona treguan se, për çdo 1 orë gjumë të humbur

në ditë ka rreth 27% më shumë për t'u prekur nga disa sëmundje.

Këtu listohen kryesisht problemet me mbipeshën, diabeti, kolesterolit i lartë apo presioni i lartë i gjakut. Prandaj ekspertët e cilësojnë gjumin si një faktor shumë të rëndësishëm në shëndetin e mirë të organizmit.

Por sa orë duhet të flini? Siç përmendëm dhe më sipër, gjumi i mirë dhe i qetë gjatë gjithë natës ndikon ndjeshëm jo vetëm në aktivitetet e përditshme. Mund të jetë shumë i rrezikshëm për shëndetin dhe të këtë pasojë në krijimin e sëmundjeve afatgjata.

Mjekët rekomandojnë të flini të paktën 8 orë gjumë pa ndërprerje çdo natë. Bëjeni këtë rutinë të njejtë për çdo natë për të ndihmuar sa më shumë organizmin. Në këtë mënyrë trupi juaj do të kryejë të gjitha proceset e tij në mënyrë normale duke u shpërndarë. Gjithësesi zhvillimi i sëmundjeve kronike si diabeti apo ato kardiovaskulare ndikohet edhe nga faktorët tjerë. Mundohuni që përveç një pushimi të mirë dhe gjumi të thellë, të mbani nën kontroll edhe stilin tuaj të jetesës.

	Autor: GAZMEND MORINA	AKTORJA ITALIANE NË FOTO (shqip.)	MBARIMI I BOTËS (pashq.)	MË VJEN GJUMË E MË VARET KOKA DUKE NDENJUR	AMPER, JEMEN, ELEKTRON	RRALLË (lat.)	ZANORE	SUDOKU									
	MEKANIZËM QË SHËRMBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE TË RËNDA	<input type="checkbox"/>							7				1	4		3	
	KRAHINË NË KOSOVË	<input type="checkbox"/>						I ÇELE	2			8				9	7
	ZYRË NDIHME JURIDIKE QË MERRT ME VEPRIMET NOTERIALE	<input type="checkbox"/>							9		3	1		8			
	MARKË E VESHJEVE SPORTIVE (origj.) FURRË KU PIQEN TULLA	<input type="checkbox"/>									4				1		
	AKTORI HOLLIVUDIAN .. PAÇINO	<input type="checkbox"/>			ZË ME DORË QË NUK I PËRKET FESË DHE KLERIT						7		5		2	9	8
	DYPALËSH	<input type="checkbox"/>												6		4	5
	AKTORI HOLLIVUDIAN .. PAÇINO	<input type="checkbox"/>			ZË ME DORË QË NUK I PËRKET FESË DHE KLERIT				CEREMONITË FETARE						3		7
	DYPALËSH	<input type="checkbox"/>															
	DYPALËSH	<input type="checkbox"/>															
EPOKA ERE	KANAT	PROVINCË NË ITALI	ZANORE	EPOKA ERE	QYTET MË GJERMANI (pashq.)	PARA TË DYTËS "I" NË MES TË DY "E"											
BISHT I FRUTIT TË DISA PEMËVE E PERIMEVE				NJËRI NGA KATËR SHTETET QË FORMOJNË MBRETËRINË E BASHKUAR ZANORE													
VARIOLË			SHKRIMTARI ALI LLOJ KROKODILI				DISIPLINË SPORTIVE AKTORJA ITALIANE ROSELLINI (shqip.)							BRITMË E LOPËS AUTOMJETI			
SOLISTJA QAZIMI			DUELI I BOKS GRIMCOVA (bised.)				SHTET (huaj) PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE							PJESË E TULTË E TRUPIT KRYEQYTETI I FILIPINEVE			
KËNGËTARE E JONA				ZANORE	I TAKON BURRË I GUXIMSHËM									AJKA E QUMËSHIT DAULLJA			
							KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTAR UNIVERSITETI LIMERICK ORCHESTRA									NJË PLANET	
MASA NDËSHKIMORE (sh.shq.) SHIU I IMËT				LLOJ GURI I ÇMUESHËM BASHKËT.						FUTBOLLISTI ANGLEZ UËJN (MAN. UTD.) BASHKËT.						ZANORE TRAJNERI YNË VOKRRI	
EPOKA ERE	KOMANDANT I NJË ANIJEJE	ZANORE QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE		MËDYSHJET FAZA						FUTBOLLISTI STIVEN (EVERTON) AFTËSI E PAGIMIT (treg.)							
SUPER MODELJA AMERIKANE UPTON (orgj.)				LLOJ PEME (sh.shq.) SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË						POEMË E VOGËL (shq.) MODELJA KRASNIQI							
NITROGJENI					SHPIRTI (Lat.)	AGIM TEJECI ARTAN (perkdh.)			HAPËSIRË E CAKTUAR TERRITORIALE (shq.) BASHKËT.					INDIUM FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN)			
PARAKALIM USHTARAK (sh.shq.)							SHTET NË AZI ISH FUTBOLLISTI KROAT TUDOR							ALUMIN PËRKULJE NË NJËRËN ANË		KRYEQYTETI I PERUSË	
IGLI TARE			EKSPOZITË E MADHE AKTORJA & MODELJA ANGLEZE ... HURLEY							NAIM ISMAJLI TRUP GJEOMETRIK				AZEM BEJTA MENDIM		BASHKËT. RINOR (perkdh.)	
BASHKËT.		GABZHERR, GURMAZ PAMELA ANDERSON															
EPOSI			ERMELINDA MEKSI ZANORE				TRAJNERI GJERMAN REHAGEL BASHKËT.									BOTIM	
OJNA																PËRSHËND-ETJE ALLATURKA	

ZGJIDHJA E FJALËKRËQIT: MAKARA, OPOJA, NOTERI, NIKE, H. KAMINA, AL. KAP, BILATERAL, M. E PARA, ILIRI, FRE, UELLSI, LITERAR, LI, ALIU, KRËKËT, MU, EMA, MËCI, ETAR, MISH, GIL, I. ZATËT, MAZA, DËNIMET, ANITA TAKE, RIGA, RUBIN, RUMI, U. A. DILEMAT PINAR, KATE, MOLLAT BALADA, AZOTI, AT. ZONA, IN, PARADAT, OMANI, AL, IT, PANAIR, NI, AB, L, T, LARING, KATINARI, EPI, EM, OTO, EDITIM, NAZE, AGRON, TEMENA. ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona 1: 785 691 423; KII: 416 325 897; KIII: 239 874 516; KIV: 923 168 754; KV: 854 739 162; KVI: 671 542 938; KVII: 197 286 345; KVIII: 568 413 279; KIX: 342 957 681.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sport



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'



TEL: 045 82 82 82

Kosova me synime të mëdha ndaj Polonisë

Trajneri i Kosovës, Taip Ramadani, ka bërë me dije se e ka studiuar mirë kundërshtaren e radhës, Poloninë, dhe se i njeh mirë përparësitë dhe dobësitë e saj. Ai beson se hendbollistët 'dardanë' do t'i shfrytëzojnë pikat e dobëta të polakëve për të arritur deri te sukcesi. Ndërsa hendbollisti Enis Kabashi ka thënë se synohet që në këtë ndeshje të tregohet se sukcesi ndaj Izraelit nuk ka qenë i rastësishëm. Ndeshja Kosova - Polonia zhvillohet sonte nga ora 20:00



EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll është maksimalisht e përgatitur për ndeshjen e radhës ndaj Polonisë, e cila është ndeshja e parafundit e fazës së dytë kualifikuese për "Euro 2020". Kjo ndeshje zhvillohet sonte (e mërkurë) nga ora 20:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, kurse synim i "dardanëve" është fitorja. Trajneri Taip Ramadani ka thënë para kësaj ndeshje se e njeh shumë mirë ekipin kundërshtar dhe se Kosovës i duhet t'i shfrytëzojë dobësitë e polakëve. "Është hera e tretë që takohemi me Poloninë, prandaj i njohim mirë cilësitë dhe dobësitë që ka. Neve na mbetet të përfitojmë nga këto dobësi. Jam i kënaqur me përgatitjet

tona deri më tani, pasi djemtë kanë punuar në nivel të lartë dhe janë të fokusuar në detyra. Më lë përshtypje fakti që janë duke diskutuar më shumë mes vete gjatë stërvitjeve dhe janë duke analizuar lojën e polakëve më shumë vëmendje", ka thënë Ramadani, i cili ka konfirmuar edhe mungesat e dy hendbollistëve: Bujar Ramosajn dhe Rron Ramadani. "Na mungon mbrojtësi Ramosaj, që ka bërë një operim në dorë para pak ditësh dhe Rron Ramadani. Shpresoj se mund t'i kompensojmë këto mungesa në mënyra të tjera. Alo e majtë, Lulzim Shabani, do të debutojë në Prishtinë pas një sezoni të mrekullueshëm me Kastriotin. Ka shpejtësi mahnitëse dhe potencial që në të ardhmen të zhvillohet në lojtar të nivelit të lartë. Familja, shoqëria dhe klubi duhet të krenohen me të.

Shpresojmë për një mbështetje nga tribunat dhe të jeni të sigurt se do të derdhim edhe djersën e fundit në parket", ka shtuar Ramadani. Për ndeshjen ndaj kombëtares polake ka folur edhe një nga hendbollistët më të mirë të Kosovës, Enis Kabashi. Ai ka thënë se Kosova dëshiron t'i tregojë Evropës që fitorja kundër Izraelit nuk ishte e rastësishme. "Jemi një grup lojtarësh që njihemi mirë, jemi shumë vite bashkë. Atmosfera në ekip është shumë e mirë. Kundër Polonisë presim përkrahje të madhe nga publiku, që të jetë lojtari ynë i tetë. Duam t'i tregojmë Evropës që fitorja kundër Izraelit nuk ishte e rastësishme, por mesazh për të gjitha ekipet mesatare evropiane, se Kosovën nuk do ta mposhtin lehtë, sidomos në shtëpinë tonë", ka deklaruar Kabashi.

SHKURT

Bashakshehri konfirmon interesimin për Muriqin

Vedat Muriqi ka shënuar një nga golat e fitores në ndeshjen që Kosova e fitoi në Sofje ndaj Bullgarisë (2-3). Forma e mirë e ish-sulmuesit të Lirisë së Prizrenit ka bërë që të shtohen skuadrat e interesuara për shërbimet e tij. Skuadra e fundit që e dëshiron në radhët e veta sulmuesin Muriqi është ajo e Bashakshehrit. "Si në mbrojtje, ashtu edhe në sulm dëshirojmë të transferojmë lojtarë. Do të doja ta shihja Vedat Muriqin në stafin tim. Nëse na lejon Çaykur Rizespori ne do t'i nisim negociatat me lojtarin", ka thënë Okan Buruk, trajner i Bashakshehrit.

Gjilani transferon Jackson Ferreiran

SC Gjilani ka arritur marrëveshje me futbollistin brazilian Jacskon Ferriera për të qenë pjesë e klubit për edicionin e ardhshëm. 28-vjeçari Ferriera, i cili luan në pozitën e mbrojtësit të krahut të majtë, edicionin e kaluar ishte pjesë e FC Luftëtarit në Kategorinë Superiore, derisa në të kaluarën ishte pjesë e shumë klubeve të njohura në Brazil dhe Greqi.

Haxho vazhdon kontratën me Llapin

Portieri Eglant Haxho ka vazhduar kontratën edhe për një vit me skuadrën e Llapit. Haxho ka pasur paraqitje tejet të mira në stinorin e fundit dhe do të vazhdojë t'i japë siguri portës së skuadrës që drejtohet nga Tahir Batatina.

Zeneli mungon nëntë muaj

Reprezentuesi i Kosovës dhe anëtar i skuadrës franceze, Stade de Reims, Arbër Zeneli do të mungojë deri nëntë muaj për shkak të lëndimit që pësoi në ndeshjen e Kosovës me Malin e Zi në kualifikimet për "Euro 2020". Ai lëndoi rëndë gjurin e këmbës dhe menjëherë pas ndeshjes në Podgoricë ishte nisur drejt Francës për ekzaminime mjekësore. Tani klubi ka konfirmuar lëndimin e rëndë dhe ka thënë se pritet që ai të mungojë në një periudhë mes 7 dhe 9 muajsh.

Turnir për ditën e çlirimit dhe dëshmorët e Ruhotit

Më 15 qershor do të organizohet turnir në futboll të vogël për nder të çlirimit të fshatit Ruhot dhe për nder të dëshmorëve të rënë nga ky fshat. Organizatorët e këtij turniri kanë bërë me dije se turniri do të mbahet në qendrën sportive "Dardania" në Qysh nga ora 11:00, kurse për dy ekipet fituese do të ketë edhe shpërblime. Ky turnir pritet të jetë madhështor dhe numri i ekipeve pjesëmarrëse do të jetë i madh.

Pogba: Islami më ka bërë njeri më të mirë

MANCHESTER, 11 QERSHOR - Ylli i Manchester Unitedit, Paul Pogba, muajin e kaluar bëri një pelegrinazh në Mekë gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit, edhe pse nuk lindi mysliman, pavarësisht besimit të nënës së tij. Por, pasi kaloi një periudhë të vështirë, Pogba ven-

dosi ta hulumtojë fenë dhe ta ndjekë numrin e miqve duke praktikuar islamin. Mesfushori, i cili mbetet një objektiv transferimi për Real Madridin këtë verë, ia atribuon të gjitha fesë islame pasi, sipas tij, ai është bërë person më i mirë. I pyetur se çfarë do të

thotë të jesh një mysliman për të në podcastin e ri të "The Times", Pogba ka deklaruar: "Është gjithçka. Kjo është ajo që më bën mirënjohës për gjithçka. Më bëri të ndryshoja, t'i kuptoja gjërat në jetë. Me mend, ndoshta, kjo më bën më paqësor brenda". "Islami nuk

është imazhi që të gjithë e shohin - terrorizmi. Ajo që dëgjojmë në media është me të vërtetë diçka tjetër, ndërsa ajo në realitet është diçka e bukur. Më ka bërë edhe njeri më të mirë. Kushdo që mund të gjej paqe mund të lidhet me Islamin", ka shtuar Pogba.



Feronikeli dhe Prishtina mësojnë kundërshtaret në Evropë

Lincoln Red Imps është kundërshtarja e Feronikelit në garat paralelimatore të Ligës së Kampionëve, kurse St Joseph's është kundërshtarja e Prishtinës në Ligën e Evropës

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Kampionia dhe fituesja e Kupës së Kosovës në futboll, Feronikeli e ka mësuar kundërshtarin e parë të paralelimatoreve në Ligën e Kampionëve. Skuadra nga Drenasi në gjysmëfinale do të ketë përballë kampionen e Gjibraltarit, Lincoln Red Imps, ndërkohë që në rast triumfi në finale e raundit paralelimator do të sfidojë fituesin e çiftit Tre Penne të San Marinos ndaj Santa Coloma të Andorrës. Rivali i Feronikelit nuk është krejtësisht i panjohur për skuadrat kosovare pasi një vit më parë Drita e mposhti brenda në Gjibraltar me rezultatin e thellë 4-1 pikërisht Lincoln Red Imps në finalen e raundit paralelimator duke siguruar pikërisht kalimin në raundin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve. Ndeshtet gjysmëfinale do të zhvillohen në datën 25 qershor ndërsa finalja në 28 qershor. Të gjitha ndeshjet do të zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë me Feronikelin që këtë



vit do të ketë avantazhin e fushës ndaj rivalëve. Pas Feronikelit, kundërshtarin për garat ndërkombëtare e ka mësuar edhe skuadra nënkampione e Kosovës, Prishtina. Kundërshtari i Prishtinës në raundin paralelimator është skuadra e tretë e kampionatit të Gjibraltarit, St Joseph's. Ndeshtja e parë zhvillohet në Prishtinë më 27 qershor në sta-

diumin e qytetit, kurse ndeshja e dytë më 4 korrik. Prishtina edicionin e kaluar kishte mposhtur FC Europa po të Gjibraltarit, në ndeshjen e parë në Gjibraltar kishte luajtur 1-1, ndërsa në atë kthyesë në Mitrovicë 5-0. FC Prishtinën në shortin e hedhur në Nyon të Zvicrës e ka përfaqësuar menaxherja për marketing, Shkenca Goçi.

Golden State ruan shpresat për titull

TORINO, 11 QERSHOR - Skuadra e Golden States fitoi 106-105 ndaj Torontos në finalen e pestë "play-off" në NBA, duke mbajtur të gjalla shpresat për titullin kampion. Kanadezët udhëheqin tashmë 3-2 serinë e finaleve, duke humbur shansin e parë për t'u shpallur kampionë. Ndeshtja e luajtur në Toronto ishte me rivalitet e spektakolare, teksa në fushë u rikthye pas një muaji edhe Kevin Duranti. Gjithsesi, aventura e tij (11 pikë në 11 minuta) zgjati shumë pak, pasi la fushën e lojës i dëmtuar. Dyshohet se MVP i finaleve të vitit të kaluar ka dëmtuar Thembrën e Akilit. Ndeshtja ishte me dy pamje, më e mirë për Toronton në shumicën e kohës, madje kanadezët u shkëputën deri në 14 pikë në periudhë të tretë. Ai që shkëlqeu për vendësit ishte i zakonshmi Kawhi Leonard, 26 pikë e 12 rebounde për të. 6 lojtarë të ekipit kanadez realizuan mbi 10 pikë, por këtë herë kjo



nuk mjaftoi për ta fituar ndeshjen dhe titullin. Në kahun tjetër shkëlqyen Stephen Curry (31 pikë) e Klay Thompson, 26 pikë, një dyshe që në fundin e periudhës së tretë dhe të katërt bënë dallimin në fushë. Së bashku ata realizuan 12 gjuajtje të sakta nga distanca (7 Thomson e 5 Curry), duke qenë të papërmbyshëm. Tashmë seria e

ndeshjeve finale rikthehet në fushën e Golden State, që ka një tjetër shans për ta mbrojtur titullin kampion. Gjithsesi, e sigurt mungesa e Kevin Durantit, që ka mbyllur sezonin dhe, ndoshta, nuk do të luajë më asnjë ndeshje deri në dhjetor. Ndërsa Toronto do të tentojë sërish mrekullinë, këtë herë në fushën e rivalëve.

SHKURT

Tottenhami dhe Arsenali e duan Strakoshën

Hugo Lloris pritet të largohet nga Tottenham Hotspuri dhe portieri shqiptar i Lazios, Thomas Strakosha, po shihet si zëvendësues i francezit. Paulo Gazzaniga është aktualisht portieri i dytë i skuadrës angleze, mirëpo nuk ka arritur të dëshmojë se e meriton vendin e titullarit, prandaj "Spurs" po mendon që Strakosha të jetë pasardhës i Llorisit. "La Gazzetta dello Sport" raporton se edhe Arsenali është skuadra e dytë angleze që e dëshiron portierin Strakosha.

Ankohet Vetteli: Po na vjedhin

Skandali i ndodhur fundjavën që lamë pas në Formula 1 vijon të përflitet me Sebastian Vettelin, i cili vazhdon të jetë i tërbuar me atë çfarë ndodhi. Në një prononcim të dhënë së fundmi për mediat, piloti gjerman shpërthen duke thënë se po vidhet hapur. Vetteli deklaroi se nuk di çfarë të bëjë më tepër. "Nuk kisha ku të shkoja, realisht nuk kisha ku të shkoja. Ku duhet të shkoj? Çfarë duhet të bëj? Më thonë të fokusohem dhe jam i fokusuar, por po na vjedhin!", ka thënë Vetteli.

Fonseca, trajner i Romës

Klubi i Romës i ka dhënë fund pritjes dhe ka zyrtarizuar trajnerin e ri, Paulo Fonseca. Portugezi do t'i drejtojë verdhekuqtë për dy sezonet e ardhshme dhe nëse çdo gjë shkon mirë, mund zgjasë marrëveshjen për vitin e tretë. Fonseca do të përfitojë 2.5 milionë euro në sezon. Klubi e ka zyrtarizuar teknikun nëpërmjet një komunikate zyrtare, duke i uruar mirëseardhje trajnerit. Fonseca la Shakhtarin, aty ku bëri një punë të mrekullueshme, duke krijuar një ekip simpatik që luan futboll sulmues. 46-vjeçari nuk do ta ketë të lehtë të bëjë një ekip të fortë dhe kompetitiv te Roma, pasi shumë lojtarë kërkojnë të largohen nga verdhekuqtë.

Lazio pas Robbenit

Lazio duket se është gati të bëjë një goditje të madhe në afatin kalimtar, me parametra zero. Siç bën me dije "Il Messaggero", Claudio Lotito ka në plan të parë, holandezin Arjen Robben, i cili u largua nga Bayerni pas disa sezonesh. Duket se klubi lacial kërkon të bëjë një goditje si ajo e Miroslav Kloses, i cili ishte pjesë e skuadrës italiane para disa sezonesh. Nuk raportohet për bisedime apo oferta mes palëve, por thjesht për një interesim dhe vëzhgim, që po i bën Lazio rastit të Robbenit. Tashmë pritet me interes, ky operacion dhe nëse Lazio do të bënte një afrim të bujshëm në verë.

Neymari planifikon largimin nga PSG-ja

Ylli brazilian i Paris Saint Germainit, Neymar, ka prishur çdo raport me drejtuesit e skuadrës franceze dhe e ardhmja e tij me shumë gjasë nuk do të vazhdojë të jetë në Ligën 1. Siç raporton gazeta katalanase "Sport", braziliani u ka shprehur dëshirën për t'u larguar drejtuesve të PSG-së, ndërkohë që edhe trajneri Thomas Tuchel nuk e do më në skuadër pasi i është lodhur nga sjellja e numrit 10, për më tepër që 27-vjeçari ka filluar të dëmtohet shumë shpesh. Barcelona po e monitoron me kujdes situatën në të cilën është përfshirë sulmuesi dhe blaugranat interesohen më tepër për Neymarin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Zyrtar për statistika ne zyrën rajonale në Prishtinë
Numri i referencës:	ASK-DRA-001
Tarifa e shërbimit:	378.56 bruto
Raporton te:	Zyra rajonale në Prishtinë
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Trc (3) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ckrkutuesve:	ASK- 1

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1 Sigurimin e formularëve, kontrollimi dhe plotësimi i formularëve te respodenteve,
- 2.Shpërndarja e formularëve dhe pranimin e tyre,
- 3.Angazhimi në përcjelljen e çmimeve të produkteve të konsumit të gjerë ,
- 4.Grumbullon , kontrollon dhe azhuron të dhënat e buxhetit familjar në regjionin e Prishtinës dhe te njëjtat ju përcjellë shërbimeve gjegjëse në ASK-se.,
5. Angazhimi në anketën e fuqisë punëtore si dhe në anketën e biznesit te ndërmarrjeve, bujqësisë,
- 6.Angazhimi në regjistrimin e qarqeve statistikore , ekonomive familjare,
7. Grumbullon , kontrollon dhe azhuron te dhënat e demografisë se regjionit te Prishtinës dhe te njëjtat ju përcjelle shërbimeve gjegjëse ne ES te Kosovës.
8. Për punën e vet i përgjigjet eprorit të drejtëpërdrejt.

Kualifikimi :

-Diploma e shkollës së mesme apo student i fakultetit (e preferuar)

Përvoja e punës: e preferueshme

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e kompjuterit (Word ,Excel, Outlook) ,
- Bashkëpunimi në mënyrë ckipore e nevojshme,
- Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarikë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në ueb faqen e ASK-së.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhivën e ASK-së, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës , Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. **Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit , në tel: 038-20031149 , prej orës 08:00 - 16: 00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33, Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo i člana 12, stava 4, Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agjencia za Statistiku Kosova, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	Agjencia za Statistiku Kosova
Naziv radnog mesta:	Službenik za Statistiku u Regionalnoj Kancelariji u Prištini
Referentni broj:	ASK-OPA-001
Tarifa usluga:	378.56 bruto
Izveštava:	Regionalna Kancelarija u Prištini
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge-(SPU)
Trajanje ugovora:	Tri (3) meseca
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK- 1

Zadaci i odgovornosti:

- 1 Obezbeđivanje obrazaca, praćenje i popunjavanje obrazaca ispitanika;
2. Raspodela i primanje obrazaca;
- 3., Angazovanje u praćenju cena robe široke potrošnje;
- 4.Prikuplja, kontroliše i ažurira podataka u budžetu domaćinstava u regionu Pištine i iste podatke šalje odgovarajućim uslužnim odeljenjima u ASK.,
5. Angazovanje u Anketi o Radnoj Snazi, kao iu Anketu Poslovanja Preduzeća, Poljoprivrede;
6. Angazovanje u upisu popisnih krugova, domaćinstava;
7. Prikuplja, kontroliše i ažurira demografske podatke regiona Prištine i iste podatke šalje odgovarajućim uslužnim odeljenjima u ASK;
8. Za svoj rad odgovara direktno svom nadređenom.

Kvalifikacija:

- Diploma srednje škole ili student na fakultetu (poželjno)

Radno iskustvo: Poželjno

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje rada na računaru (word, excel, Outlook),
- Saradnja u timski rad, potrebni;
- Sposobnost da sačuva poverljivost pojedinačnih statističkih podataka;
- Dobre veštine komunikacione, uključujući sposobnost tumačenja informacija, pružanja smernica i prenošenja informacija drugima;

Agjencia za Statistiku Kosova dočekuje aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica.

Uslovi učešća na konkurs

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (više od 18.godina) Građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na internet stranici ASK-a

Podnošenje prijave:Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se uzimaju i podnesu u Agenciju za Statistiku Kosova , Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz prijavu potrebno je priložiti: Kopiju lične karte, kopije dokumenata o kvalifikacijama kao i ostalu potrebnu dokumentaciju koja je potreba prema konkursu.

Zahtevi podneti posle roka konkursa neće biti prihvaćeni. Nepotpune prijave će biti odbijene.

Samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona : 038- 200 31149 od 08:00 – 16: 00 časova.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Glllogoc
Zyra e Personelit
01Nr: MM/1-31818 dt. 10/06/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Glllogoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për pozitën : Inspektor I tregut

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Glllogoc
Nr. i konkursit:	APF0005477
Pozita e punës:	Inspektor i tregut
Institucioni:	Komuna Drenas
Divizioni/njësia:	Drejtoria e Inspektoratit
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtor i Drejtorisë në Komunë
Kategoria Funktionale –Grada	Niveli Profesional, grada 8, Koefficienti 7
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 8, Koefficienti 7 : Drejtoria e Inspektoratit, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore:

1. Inspektim për regjistrim të bizneseve ;
2. Inspektim për mbrojtjen e konsumatorit;
3. Inspektim për zbatim të orarit të punës;
4. Inspektim për deklaracion të mallit;
5. Inspektim për mbishkrimet e firmave;
6. Inspektim për mbajtjen e librave hyrese dhe dalëse;
7. Inspektimi rreth çmimeve;
8. Punë dhe detyra tjera sipas urdhërit të Shefit apo Drejtorit.

Kualifikimi i nevojshëm arsimor,(aftësitë, përvoja si dhe shkathhtësitë tjera që kërkojnë për këtë vend të punës):

Diplomë universitare , 3 vite përvojë pune ;
Fakulteti Ekonomik, Juridik apo Administratë Publike.
Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin
Aftësi për përbushjen e detyrave dhe punëve nën presion
Shkathhtësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, internet);

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.
Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, çertifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kriterëve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data 10/06/2019 deri më 24/06/2019, për pozitën e cekur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes web faqes së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.

Udhëheqëse e Personelit
Hamishaha Shabani



Shënim: Për shkaqe teknike publikohet me një ditë vonesë në shtypin e shkruar.

Agjencia për Informim dhe Privatësi

Konkurs për Dizajnimin e Llogos

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) u bën thirrje të gjithë të interesuarve, e në veçanti studentëve të dizajnit grafik dhe studentëve të tjerë të fushave të përafërta që të aplikojnë në konkursin për dizajnimin e llogos së AIP-së.

Konkursi është i natyrës garues dhe tri idetë më të mira do të shpërblehen si në vijim:

- Ideja e parë më e suksesshme shpërblehet me €800;
- Ideja e dytë më e suksesshme shpërblehet me €600; dhe
- Ideja e tretë më e suksesshme shpërblehet me €400.

Të gjitha të drejtat autoritale mbi llogon e përzgjedhur, përpunimi dhe përdorimi i saj, barten nga autori te AIP. Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i ngritur ad-hoc nga AIP, në bazë të kriterëve të poshtëshënuara:

- Të jetë në përputhje me fushëveprimtarinë e AIP- së (bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike);
- Të jetë kuptimplotë dhe të shprehë funksionin, mandatin dhe detyrat e AIP-së;
- Të reflektojë vizionin dhe misionin e AIP-së;
- Të jetë unike, e lehtë për t'u dalluar dhe për t'u mbajtur në mend;
- Të jetë praktike që të mund të përdoret në të gjitha materialet e AIP-së;
- Të jetë e veçantë dhe të mos jetë e kopjuar nga llogot e institucioneve, kompanive apo ndonjë entiteti tjetër;
- Të përmbajë atributet e përafërta të stemës së shtetit;
- Të jetë e qëndrueshme, bashkëkohëse dhe jetëgjatë;
- Në rast të përdorimit të inicialeve apo tekstit të plotë të emërimit, të përdoren inicialet apo teksti për të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës;
- Në rast të përdorimit të plagjiaturës, autori do të mbajë përgjegjësinë e bazuar në legjislacionin përkatës.

Konkurimi:

Dizajnet duhet të dorëzohen në pliko të mbyllur, e cila duhet të përmbajë:

- Punimet e shtypura në letër dhe në CD;
- Punimet duhet të përmbajnë vetëm një kod/shifër identifikuese, jo të dhëna personale të autorit;
- Të dhënat personale të autorit duhet futur në një zarf tjetër më të vogël, i cili hapet vetëm pas përzgjedhjes së llogos;
- Punimet e dorëzuara në Agjenci, nuk i kthehen më autorit.

Propozimet e mbyllura në zarf duhet të sillen në zyrën nr.02 të AIP-së, në adresën: Rr. "Luan Haradinaj" nr.36, 10 000 Prishtinë, Kosovë, nga data 12.6.2019 deri me datën 18.06.2019, në orën 16:00.

Në zarf duhet shënuar:

PËR: Agjencia për Informim dhe Privatësi

REF: Konkursi për Dizajnimin e Llogos së AIP-së

Me respekt,

Të martën më 18 qershor 2019, departamenti i Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë, do të organizojë mbrojtjen publike të disertacionit të Doktoraturës të kandidatit Gëzim QERIMI. Ceremonia e mbrojtjes fillon nga ora 11, në Amfiteatrin e Fakultetit të Filologjisë. Mbrojtja e disertacionit të doktoraturës është publike, prandaj ftohen të interesuarit që të marrin pjesë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Artan Mala shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Daut Misiri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Ramiz Sadiku" Skenderaj.

► Fatmir Qerkinaj shpall te pavlefshme dëftesën e klasës se trete (III) dhe katërt (IV) shkolla e mesme teknike SHMT "Anton Çetta" Skenderaj.

► NT "Kabashi - 2" ShPK shpall te pavlefshme certifikatën e TVSh: 330024993 Prizren

► S.R. "MB. prom " shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit: 80443629 Prizren

► Iliaz Buduri shpall te pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Perparim Abazi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Leke Dukagjini" Prizren

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

PA LIMIT MIN & SMS 3GB



4.99€

*Pako përmban edhe 300 minuta me operatorë tjerë në Kosovë.



Pakot mujore të Ofertës më të mirë n'botë përmbajnë benefite të kombinuara si minuta PA LIMIT brenda rrjetit, minuta me operatorë tjerë, SMS PA LIMIT drejt të gjithë operatoreve dhe internet në mobil.

IDEALE

MIN&SMS PA LIMIT
+300 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
3GB

4.99€

PLUS

MIN&SMS PA LIMIT
+500 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
5GB

6.99€

TOP

MIN&SMS PA LIMIT
+700 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
10GB

12.99€

FANTASTIK

MIN&SMS PA LIMIT
+1000 MIN
DREJT OPERATORVE TJERË
20GB

17.99€

*Pasi që shpenzoni minutat me operatorë tjerë, çmimi për minutë është vetëm 5 cent.

Balancin e benefiteve e kontrolloni duke thirrur *123#

Vizitoni pikën më të afërt të IPKO-së për të marrë njëren nga këto pako.

WWW.IPKO.COM

